



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 201**

**27 dhjetor**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe	
Ligj nr. 172/2013 datë 5.12.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar.....	8177
Ligj nr. 173/2013 datë 5.12.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimin mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin.....	8182
Ligj nr. 174/2013 datë 5.12.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për forcimin e shtetit të së drejtës, qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse .....	8197

**LIGJ**  
**Nr. 172/2013**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MOLDAVISË PËR  
RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.12.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8440, datë 24.12.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
REPUBLIKËS SË MOLDAVISË PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË  
PAAUTORIZUAR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Moldavisë, këtu të ashtuquajtura “palë”;

*duke dëshiruar* në zhvillimin e marrëdhënieve të përbashkëta, me qëllim për të siguruar zbatim më të mirë të dispozitave lidhur me lëvizjen e personave;

*të bindur* për domosdoshmërinë për të luftuar migracionin ilegal dhe me qëllimin për të lehtësuar, në baza reciproke, ripranimin e personave që hyjnë dhe dalin ilegalisht nga territori i secilës palë;

*në përputhje* me marrëveshjet ndërkombëtare, konventat dhe të tjera dokumente me të cilat shtetet e palëve janë lidhur,

kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

**Përkufizimet**

Bazuar në objektivat e marrëveshjes aktuale, termat e parashtruar sa më poshtë, kanë kuptimet e mëposhtme përkatëse:

1. “I huaj” do të thotë një person që nuk ka shtetësinë e shtetit të asnjërës prej palëve.
2. “Viza” do të thotë një leje e vlefshme, e lëshuar nga autoritetet kompetente të një pale, me anë të së cilës i jepet një personi e drejta për të hyrë dhe për të qëndruar në territorin e shtetit të tij, pa ndërprerje, për një periudhë të caktuar kohe në përputhje me legjislacionin e atij shteti.
3. “Leje qëndrimi” do të thotë një leje e vlefshme, e lëshuar nga autoritetet kompetente të një pale, me anë të së cilës i jepet një personi e drejta që me këtë dokument të hyjë dhe të qëndrojë në



territorin e shtetit të palës. Leja e qëndrimit nuk presupozon një vizë dhe nuk mund të krahasohet me një leje qëndrimi të përkohshme, që i jepet një personi për ta lejuar të qëndrojë në territorin e shtetit të një pale kur kryhet procedura për ekzaminimin e aplikimit për azil apo gjatë pritjes së një procedure për dëbimin e tij/saj.

4. “Të dhëna personale” është çdo informacion për një person fizik, i cili është i identifikuar ose i identifikueshëm. Elementet me të cilat realizohet identifikimi i një personi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, janë numrat e identitetit ose faktorë të tjerë të veçantë fizikë, psikologjikë, ekonomikë, socialë, kulturorë etj.

#### Neni 2

### Ripranimi i shtetasve të shteteve të palëve

1. Palët duhet të pranojnë, sipas kërkesës që parashtron secila dhe pa formalitete të veçanta, personin që nuk përmbush ose që nuk i përmbush më kërkesat ligjore për qëndrimin e tij/saj në territorin e shtetit të palës kërkuese, nëse është provuar ose mund të pranohet si e vlefshme se një person i tillë ka shtetësinë e shtetit të palës kërkuese.

2. E njëjta procedurë aplikohet edhe për personin që e ka humbur shtetësinë e shtetit të palës kërkuese pas hyrjes së tij/saj në territorin e shtetit të palës së kërkuar, ku atij personi nuk i është garantuar shtetësia nga autoritetet kompetente të shtetit të palës kërkuese.

3. Me kërkesë të palës kërkuese, pala e kërkuar duhet që pa vonesë t’i japë personit, që konsiderohet subjekt për ripranim, sipas dispozitave të paragrafit 1 dhe 2, dokumentet e udhëtimit që i nevojiten për rikthimin e tij/saj, sipas rastit, si dhe duhet të pranojë dokumentin standard të udhëtimit të Bashkimit Europian, lëshuar nga autoritetet kompetente të palës kërkuese në përputhje me modelin e prezantuar në aneksin e marrëveshjes aktuale.

4. Nëse hetimet provojnë se personi i ripranuar nuk ka qenë qytetar i shtetit të palës së kërkuar, në momentin e largimit të tij/saj nga territori i shtetit të palës kërkuese dhe ai/ajo nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1 sa më lart ose në nenin 4, pala kërkuese duhet të pranojë detyrimin për të ripranuar menjëherë personin përkatës duke zbatuar procedurën e ripranimit.

5. Kjo procedurë nuk duhet të aplikohet nëse kërkesa për ripranim është bazuar në faktin që pala e kërkuar ka tërhequr shtetësinë e personit përkatës pas hyrjes së tij/saj në territorin e shtetit të palës kërkuese, pa i garantuar atij personi shtetësinë nga autoritetet kompetente të shtetit të palës kërkuese.

#### Neni 3

### Provimi ose prezumimi i vlefshëm i shtetësisë

1. Shtetësia konsiderohet e vërtetuar nëse paraqitet një pasaportë e vlefshme kombëtare ose një dokument i vlefshëm identifikimi, që lëshohen nga autoritetet kompetente të shtetit të palës së kërkuar për qytetarët e saj, nëse këto dokumente mund t’u jepen mbajtësve të tyre.

2. Shtetësia pranohet si e vlefshme kur paraqiten provat e para (*prima facie*), sa më poshtë:

- a) Dokumentet që u përshkruan në paragrafin 1, edhe nëse vlefshmëria ka përfunduar;
- b) Dëshmi me shkrim të personit të interesuar;
- c) Një dëshmi me shkrim lëshuar nga një person i tretë;
- d) Prova të tjera, të cilat, në raste konkrete, janë pranuar nga pala e kërkuar.

3. Nëse provat e para (*prima facie*) referuar në paragrafin 1 dhe 2 nuk janë të mjaftueshme për të provuar ose pranuar vlefshmërinë e shtetësisë, zyra konsullore ose autoriteti kompetent diplomatik i palës së kërkuar, duhet që pa vonesë të intervistojë personin e interesuar, me qëllim për të përcaktuar shtetësinë e tij/saj.

#### Neni 4

### Ripranimi i të huajve

1. Palët duhet të pranojnë, sipas kërkesës që parashtron një të huaj që ka hyrë në territorin e shtetit të palës kërkuese dhe që nuk përmbush kushtet ligjore për hyrjen dhe qëndrimin e personit në atë territor.

2. Palët duhet të ripranojnë, sipas kërkesës që parashtrojnë, një të huaj që qëndron ilegalisht në territorin e shtetit të palës kërkuese dhe që ka një leje qëndrimi të vlefshme, një vizë të vlefshme ose dokument tjetër të vlefshëm, lëshuar nga autoritetet kompetente të palës së kërkuar, duke i dhënë të drejtë personit përkatës për të hyrë dhe qëndruar në territorin e shtetit.

#### Neni 5

#### **Përjashtimi nga detyrimi për ripranimin e të huajve**

1. Detyrimi për ripranimin e të huajve sipas nenit 4, nuk ekziston në rastin kur të huajt, të cilët në momentin e hyrjes së tyre në territorin e shtetit të palës kërkuese, kanë viza të vlefshme hyrjeje ose leje qëndrimi, lëshuar nga autoritetet e kësaj pale ose i kanë marrë ato pas hyrjes në atë territor përkatës.

2. Nëse të dyja palët i kanë dhënë një të huaji, sipas kërkesës për ripranim, një vizë hyrjeje ose leje qëndrimi, pala së cilës viza e hyrjes ose leja e qëndrimit ka skaduar e fundit duhet të ripranojë atë të huaj.

#### Neni 6

#### **Tranziti**

1. Sipas kërkesës së bërë nga një prej palëve, pala tjetër autorizon të huajt, subjekt i një procedure ripranimi, drejt një shteti të tretë, për të hyrë ose për të kaluar tranzit nëpërmjet territorit të shtetit të saj. Pala e kërkuar mund të përcaktojë kushtet për lëshimin e një autorizimi të tillë, në prezencën e një përfaqësuesi të autoritetit kompetent të palës kërkuese, me qëllim për të siguruar eskortim gjatë kalimit tranzit në territorin e shtetit të saj, gjithashtu, duke kërkuar që garancia mbi aftësinë e personit përkatës për të vazhduar udhëtimin e tij/saj dhe territori i shtetit ku personi ka si qëllim destinacionin jepen në të njëjtën kohë kur paraqitet kërkesa për të kaluar tranzit.

2. Pala e kërkuar duhet t'i garantojë personit që shoqërohet dhe atij që e shoqëron viza transit falas bazuar në legjislacionin që aplikohet.

3. Nëse i huaji, subjekt i procedurës për ripranim, nuk lejohet të hyjë në territorin e një shteti të tretë ose nëse, pavarësisht nga arsyeja, vazhdimi i udhëtimit nuk është më i mundur, pala kërkuese duhet të pranohet përgjegjësi të plotë për të ndaluar të huajin dhe për ta kthyer pa vonesë në territorin e shtetit të saj.

4. Nëse arrihet në konkluzionin se personi, subjekt i kalimit tranzit, i kanoset rreziku në shtetin e destinacionit, për shkak se rrezikon dënimin me vdekje ose vuajtjes së torturës, johumanizmit, degradimit ose keqtrajtimit, si dhe nëse garancitë e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni nuk plotësohen siç duhet, pala e kërkuar ka të drejtën ta refuzojë një kërkesë të tillë.

#### Neni 7

#### **Afatet kohore**

1. Palët duhet pa vonesë të japin me shkrim përgjigjen lidhur me kërkesën për ripranimin, të dorëzuar për këtë qëllim, jo më vonë se 20 ditë punë që nga data kur një kërkesë e tillë është marrë. Kërkesa për ripranim i dërgohet autoriteteve kompetente të palës së kërkuar me e-mail, në dorë ose me çdo mënyrë komunikimi, përfshirë këtu edhe dërgimin te Misioni Diplomatik kompetent ose zyrës së palës së kërkuar. Nëse kërkesa refuzohet, duhet të jepet edhe argumentimi përkatës.

2. Pala e kërkuar pranon personin, subjekt i procedurës për ripranim, menjëherë pas komunikimit të kërkesës për ripranim dhe në çdo rast, jo më vonë se një muaj pas ditës kur jepet aprovimi. Sipas njoftimit që bën pala, ky limit kohor mund të zgjatet me kohën e harxhuar për çdo pengesë ligjore ose praktike që mund të ndodhë.

#### Neni 8

#### **Mbarimi i detyrimit për ripranim**

Kërkesa për ripranimin e një personi sipas nenit 4, duhet të dorëzohet tek autoritetet kompetente të palës së kërkuar brenda 12 muajve, nga momenti që shpallet zyrtarisht data e hyrjes ilegale ose qëndrimit ilegal të një personi të tillë në territorin e shtetit të palës kërkuese.



## Neni 9

### Mbrojtja dhe shkëmbimi i informacionit

1. Në kuadër të zbatimit të marrëveshjes, palët shkëmbejnë informacione, të cilat u referohen:
  - a) Të dhënave personale të personit që bën kërkesën për ripranim dhe kur është e nevojshme edhe të anëtarëve të tij të familjes (mbiemri, emri, emrat e mëparshëm, ditëlindja dhe vendlindja, gjinia, shtetësia e mëparshme dhe ajo aktuale);
  - b) Pasaporta, dokumenti i identitetit ose dokumente të tjera të udhëtimit (numri, data e lëshimit, autoriteti që e ka lëshuar një dokument të tillë, vendi ku është lëshuar dokumenti, periudha e vlefshmërisë së dokumentit, vlefshmëria territoriale);
  - c) Të dhëna të tjera të nevojshme për identifikimin e personit;
  - d) Leja e qëndrimit dhe/ose viza e lëshuar nga autoritetet e shtetit të palëve ose të një shteti të tretë, itineraret, vendet ku ka ndaluar personi, biletat e udhëtimit ose masa të tjera që tregojnë që personi ka udhëtuar;
  - e) Çdo informacion që provon se personi ka qëndruar në territorin e shtetit të njëres prej palëve.
2. Palët ushtrojnë kujdes të veçantë ndaj minoreneve, të moshuarve ose personave të sëmurë, nëse është e nevojshme.
3. Informacioni i siguruar sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të transmetohet në përputhje të plotë me dispozitat e legjislacionit të aplikueshëm në shtetin e palës që i dërgon.
4. Të dhënat personale mund t'u transmetohen vetëm autoriteteve kompetente të palëve. Autoritetet kompetente të secilës palë duhet të sigurojnë mbrojtje për të gjithë informacionin mbi të dhënat personale të marra sipas kësaj marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm të shtetit të tyre përkatës.
5. Çdo palë merr përsipër:
  - a) Të përpunojë çdo informacion mbi të dhënat personale që merr sipas kësaj marrëveshjeje vetëm për qëllimin për të cilin janë kërkuar;
  - b) Të ruajë konfidencialitetin e informacioneve mbi të dhënat personale që i janë transferuar palës së kërkuar dhe të mos i transferojë te një palë e tretë nëse kalimi i tyre nuk është autorizuar nga pala kërkuese;
  - c) Të garantojë një nivel të lartë të mbrojtjes së informacioneve mbi të dhënat personale dhe të marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për t'i mbrojtur ato nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar;
  - d) Të fshijë, të shkatërrojë informacionin mbi të dhënat personale në përputhje me kushtet e përcaktuara nga pala kërkuese, nëse ato nuk plotësohen, si dhe nëse informacioni nuk përdoret më për qëllimin që është kërkuar;
  - e) Të garantojë, sipas legjislacionit kombëtar të aplikueshëm përkatës, subjekteve të të dhënave personale, të drejtën për t'u informuar për kategorinë e të dhënave rreth tyre, si dhe për qëllimin e parashikuar për përpunimin e tyre.
6. Nëse konstatohet që të dhënat personale janë transferuar apo përpunuar në kundërshtim me parashikimet e kësaj marrëveshjeje ose në kundërshtim me direktivat e së drejtës kombëtare, subjekti i të dhënave, i cenuar nga kjo, ka të drejtë të kërkojë fshirjen, korrigjimin e të dhënave apo bllokimin e përpunimit të tyre. Në rast të mospërbushjes së këtyre veprimeve, atëherë subjekti i cenuar ushtron të drejtën e ankimit në gjykatë apo në autoritetet mbikëqyrëse respektive të mbrojtjes së të dhënave personale.
7. Palët detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të kësaj marrëveshjeje.

## Neni 10

### Shpenzimet

1. Pala kërkuese merr përsipër të gjitha shpenzimet për transportimin e personit, subjekt i ripranimit sipas kësaj marrëveshjeje, përfshirë këtu edhe shoqërimin e tij deri në kufijtë e shtetit të palës kërkuese.

2. Pala kërkuese merr përsipër të gjitha shpenzimet që dalin nga përmbushja e detyrimit për të ripranuar personat siç është theksuar në nenin 2, paragrafi 4.

3. Kur bëhet fjalë për ripranimin e personave që kalojnë tranzit dhe janë subjekt i procedurës për ripranim me një shtet të tretë, pala kërkuese merr përsipër të gjitha shpenzimet lidhur me transportimin e këtyre personave dhe për shoqërimin e tyre deri në shtetin e destinacionit dhe në rast se udhëtimi nuk është më i mundur, atëherë pala kërkuese merr përsipër shpenzimet për kthimin e këtyre personave në shtetin e saj.

#### Neni 11

### **Transportimi i sendeve personale të marra ligjërisht**

1. Pala kërkuese lejon personin, subjekt i procedurës për ripranim, të transportojë te shteti i destinacionit të tij/saj të gjitha sendet që i përkasin, që i ka marrë në mënyrë ligjore sipas legjislacionit të aplikueshëm.

2. Pala kërkuese nuk ka detyrimin të mbulojë shpenzimet për transportimin e këtyre sendeve.

#### Neni 12

### **Dispozitat për zbatimin**

1. Brenda dhjetë ditëve pas hyrjes së marrëveshjes aktuale në fuqi, palët informojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, mbi autoritetet kompetente të përcaktuara për të lehtësuar komunikimin.

2. Përfaqësuesit e autoriteteve kompetente takohen kurdoherë që paraqitet e nevojshme për të analizuar modalitetet për zbatimin e marrëveshjes aktuale dhe për të rënë dakord mbi përgatitjet praktike për zbatimin e saj.

3. Të gjitha dispozitat e mëtejshme për zbatimin e saj janë përcaktuar në protokoll, që është një pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje.

#### Neni 13

### **Marrëdhëniet me instrumentet e tjera ligjore ndërkombëtare**

1. Marrëveshja aktuale është vendosur të jetë për një periudhë të pacaktuar.

2. Palët njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, mbi plotësimin e procedurave ligjore të nevojshme në shtetin e saj për hyrjen e kësaj marrëveshjeje në fuqi 30 ditë nga data e marrjes së dy njoftimeve të fundit.

3. Palët mund të pezullojnë për një periudhë të caktuar, tërësisht ose pjesërisht, zbatimin e marrëveshjes aktuale, me qëllim për të mbrojtur rendin dhe shëndetin publik, me anë të një njoftimi dërguar palës tjetër. Pezullimi duhet t'i dërgohet menjëherë palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe duhet të bëhen efektive në datën që bëhet me dije në njoftim.

4. Palët në çdo kohë mund të propozojnë ndryshime ose shtesa në marrëveshjen aktuale. Pasi palët bien dakord mbi një propozim të tillë dhe dokumentet përkatëse nënshkruhen, ato hyjnë në fuqi sipas paragrafit 2 të nenit aktual.

5. Pala mund të denoncojë marrëveshjen aktuale me anë të një njoftimi me shkrim dërguar palës tjetër. Denoncimi konsiderohet efektiv ditën e parë të muajit kur pala tjetër merr njoftimin me shkrim.

6. Kjo marrëveshje aplikohet për të gjithë personat që hyjnë ilegalisht ose ata persona, qëndrimi i të cilëve në territoret e shtetit të palëve bëhet ilegal duke filluar që nga data kur marrëveshja hyn në fuqi dhe pas kësaj, si dhe për personat që futen ilegalisht ose për personat, qëndrimi i të cilëve në territoret përkatëse bëhet ilegal pas kësaj date.

7. Aneksi është një pjesë integrale e marrëveshjes aktuale.

Bërë në Bukuresht, më 18.10.2013, në dy kopje të njëjta, në gjuhët shqipe, moldave dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllor autentike. Në rast mospërputhjes në interpretim, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.



ANEKS

Numri i regjistrimit Nr.		Dok.
E vlefshme për një udhëtim nga .....	Deri në .....	
Emri .....		
Emri i dhënë .....		
Data e lindjes .....		Fotografi
Gjatësia .....		
Shenja dalluese .....		
Shtetësia .....		
Adresa në vendin e lindjes (nëse dihet) .....		
	Autoriteti lëshues .....	
	Lëshuar në (vendi) .....	
	Lëshuar më (data) .....	
Vula / pulla	Nënshkrimi .....	
Vërejtje		
.....		
.....		
.....		
.....		

LIGJ

Nr. 173/2013

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE E IRLANDËS SË VERIUT PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimin mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.12.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8441, datë 24.12.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

## MARRËVESHJE

### NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut;

*me dëshirën* për të lidhur një marrëveshje për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, kanë rënë dakord si më poshtë:

#### Neni 1

#### **Personat e përfshirë**

Kjo marrëveshje zbatohet për persona, të cilët janë rezidentë të një ose të dy shteteve kontraktuese.

#### Neni 2

#### **Tatimet e përfshira**

1. Kjo marrëveshje zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin që vendosen në emër të një shteti kontraktues ose nënndarjeve të tij politike apo autoriteteve lokale, pavarësisht nga mënyra në të cilën vendosen.

2. Konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet që vendosen mbi të ardhurat në tërësi, kapitalin në tërësi ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit, duke përfshirë tatimet mbi të ardhurat kapitale nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme ose të paluajtshme.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet marrëveshja janë veçanërisht:

a) në Shqipëri:

i) tatimet mbi të ardhurat, duke përfshirë tatimin mbi fitimin e shoqërive, tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin e fitimeve kapitale nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme ose të paluajtshme;

ii) tatimi i aktiviteteve të biznesit të vogël;

dhe

iii) tatimi mbi pasurinë;

(më poshtë të quajtura “tatimi shqiptar”);

b) në Mbretërinë e Bashkuar:

i) tatimi mbi të ardhurat;

ii) tatimi i shoqërive; dhe

iii) tatimi i fitimeve kapitale;

(më poshtë quhet “tatimi i Mbretërisë së Bashkuar”).

4. Marrëveshja zbatohet edhe për çdo tatim të njëjtë ose thelbësisht të ngjashëm që vendoset pas datës së nënshkrimit të marrëveshjes si shtesë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim domethënës që është bërë në ligjet e tyre tatimore.

#### Neni 3

#### **Përkufizime të përgjithshme**

1. Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) termi “Shqipëri” është Republika e Shqipërisë dhe, nëse përdoret në kuptimin gjeografik, është territori i Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi të, si dhe çdo zonë tej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë që, në bazë të ligjeve të saj dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, është në zonën brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin detar dhe nëntokën, dhe burimet e tyre natyrore;





b) termi “Mbretëri e Bashkuar” është Britania e Madhe dhe Irlanda e Veriut, duke përfshirë çdo zonë jashtë detit territorial të Mbretërisë së Bashkuar, të përcaktuar sipas ligjeve të saj në lidhje me shelfin kontinental dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, si një zonë brenda së cilës mund të ushtrohen të drejtat e Mbretërisë së Bashkuar në lidhje me shtratin detar dhe nëntokën, dhe burimet e tyre natyrore;

c) termat “një shtet kontraktues” dhe “shteti tjetër kontraktues” janë Mbretëria e Bashkuar ose Shqipëria, siç e kërkon konteksti;

d) termi “person” përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo organizim tjetër personash;

e) termi “shoqëri” është një person juridik ose subjekt që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

f) termi “ndërmarrje” i takon zhvillimit të çdo lloji biznesi;

g) termi “ndërmarrje e një shteti kontraktues” dhe “ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues” është përkatësisht një ndërmarrje e zhvilluar nga një rezident i një shteti kontraktues dhe një ndërmarrje e zhvilluar nga një rezident i shtetit tjetër kontraktues;

h) termi “trafik ndërkombëtar” është çdo transport me anije ose avion të operuar nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues, përveç kur anija ose avioni operohet vetëm ndërmjet vendeve në shtetin tjetër kontraktues;

i) termi “autoritet kompetent” është:

i) në Shqipëri, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e autorizuar nga ministri i Financave;

ii) në Mbretërinë e Bashkuar, Komisionerët e të Ardhurave dhe Doganave të Madhërisë së Saj ose përfaqësuesi i tyre i autorizuar;

j) termi “shtetas” nënkupton:

i) në lidhje me Shqipërinë, çdo individ që ka shtetësinë e Shqipërisë dhe çdo person juridik, partneritet ose shoqatë që merr statusin e saj si i tillë nga ligjet në fuqi në Shqipëri;

ii) në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar, çdo qytetar britanik ose çdo nënshtetas britanik, që nuk ka shtetësinë e një vendi ose territori tjetër të Komonuelthit, me kusht që ai të ketë të drejtën e qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar; dhe çdo person juridik, partneritet, shoqatë ose subjekt tjetër që e merr statusin e tij si i tillë nga ligjet në fuqi në Mbretërinë e Bashkuar;

k) termi “biznes” përfshin kryerjen e shërbimeve profesionale dhe të aktiviteteve të tjera me një karakter të pavarur.

2. Në lidhje me zbatimin e marrëveshjes në çdo kohë nga një shtet kontraktues, çdo term që nuk është i përkufizuar në të, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ai ka në atë kohë sipas ligjit të atij shteti për qëllimet tatimore për të cilat zbatohet marrëveshja, ku çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij shteti mbizotëron mbi kuptimin e dhënë termit sipas ligjeve të tjera të atij shteti.

#### Neni 4 **Rezidenti**

1. Për qëllime të kësaj marrëveshjeje, termi “rezident i një shteti kontraktues” nënkupton çdo person, i cili sipas ligjeve të atij shteti u nënshtrohet tatimeve përkatëse për shkak të vendbanimit, vendqëndrimit, vendit të menaxhimit, vendit të regjistrimit ose çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe, gjithashtu, përfshin atë shtet dhe çdo nënndarje politike ose autoritet lokal të tij. Megjithatë, ky term nuk përfshin asnjë person që i nënshtrohet tatimit në atë shtet vetëm në lidhje me të ardhurat ose fitimet kapitale nga burime në atë shtet ose kapital që gjendet në të.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident në të dyja shtetet kontraktuese, statusi i tij përcaktohet si më poshtë:

a) ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka një banesë të përhershme në dispozicion; nëse ka një banesë të përhershme në dispozicion në të dyja shtetet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit me të cilin ka marrëdhënie më të afërta personale dhe ekonomike (qendra e interesave jetike);

b) nëse shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetike nuk mund të përcaktohet ose nëse nuk ka banesë të përhershme në dispozicion në asnjë shtet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka vendqëndrim të zakonshëm;

c) nëse ka vendqëndrim të zakonshëm në të dyja shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit nga i cili është shtetas;

d) nëse ai është shtetas i të dy shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese e zgjidhin çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person i ndryshëm nga një individ, është rezident i të dyja shteteve kontraktuese, autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese përpiqen të përcaktojnë me marrëveshje të ndërsjellë shtetin kontraktues, rezident i të cilit ai person konsiderohet të jetë për qëllimet e kësaj marrëveshjeje. Në mungesë të një marrëveshjeje të ndërsjellë nga autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, personi nuk konsiderohet rezident i asnjë shteti kontraktues për qëllimet e pretendimit të ndonjë përfitimi të parashikuar nga marrëveshja, përveç atyre të parashikuara në nenet 22, 24 dhe 25.

#### Neni 5

#### **Njësia e përhershme**

1. Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, termi “njësi e përhershme” nënkupton një vend të caktuar biznesi, nëpërmjet të cilit zhvillohet biznesi i një ndërmarrjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

2. Termi “njësi e përhershme” përfshin, në veçanti:

a) një vend menaxhimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte; dhe

f) një minierë, një pus naftë ose gazi, një gurore ose një vend tjetër i nxjerrjes së burimeve natyrore.

3. Një kantier ndërtimi, projekt ndërtimi ose instalimi përbën një njësi të përhershme, vetëm nëse ai vazhdon për më shumë se gjashtë muaj.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “njësi e përhershme” konsiderohet të mos përfshijë:

a) përdorimin e mjediseve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje të mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje;

c) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të përpunimit nga një ndërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave ose të mbledhjes së informacionit për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të kryerjes për ndërmarrjen, të çdo aktiviteti tjetër të një karakteri përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët “a” deri “e”, me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit të caktuar të biznesit që rezulton nga ky kombinim, të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person, i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 6, vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ka dhe ushtron rregullisht në një shtet kontraktues autoritet për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, ajo ndërmarrje konsiderohet të ketë një njësi të përhershme në atë shtet në lidhje me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, përveç kur aktivitetet e atij personi janë të kufizuara në ato që përmenden në paragrafin 4, të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi të caktuar biznesi, nuk do ta bënin këtë vend të caktuar biznesi njësi të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.



6. Një ndërmarrje nuk konsiderohet të ketë njësi të përhershme në një shtet kontraktues vetëm ngaqë zhvillon biznesin në atë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti me autorizim të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që ata persona të veprojnë në rrjedhën e zakonshme të biznesit të tyre.

7. Thjesht fakti që një shoqëri, e cila është rezidente e një shteti kontraktues kontrollon ose kontrollon nga një shoqëri, e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues ose që zhvillon biznes në atë shtet tjetër (nëpërmjet një njësie të përhershme ose ndryshe), nuk tregon që një prej këtyre shoqërive është njësi e përhershme e shoqërisë tjetër.

#### Neni 6

### **Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme**

1. Të ardhurat që përfitohen nga një rezident i një shteti kontraktues nga pasuritë e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria), që gjenden në shtetin tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” ka kuptimin që ka sipas ligjit të shtetit kontraktues në të cilin ndodhet pasuria në fjalë. Në çdo rast, termi përfshin pasurinë ndihmëse të pasurisë së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me tokën, uzufuktin e pasurisë së paluajtshme dhe të drejtat për pagesa të ndryshueshme ose fikse, si shpërblim për punën, ose të drejtën për të punuar, depozitat minerare, burimet dhe pasuritë e tjera natyrore; anijet dhe avionët nuk konsiderohen si pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, lënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër të pasurisë së paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 zbatohen, gjithashtu, për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje.

#### Neni 7

### **Fitimet nga biznesi**

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues janë të tatueshme vetëm në atë shtet, përveç kur ndërmarrja zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur atje. Nëse ndërmarrja zhvillon biznes si më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të taten në shtetin tjetër, por vetëm për atë pjesë të atyre që i takojnë asaj njësie të përhershme.

2. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3, kur një ndërmarrje e një shteti kontraktues zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur atje, fitimet, të cilat mund të pritej të nxirrte nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e ndarë, e përfshirë në aktivitete të njëjta ose të ngjashme, sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme dhe që ka marrëdhënie tërësisht të pavarura me ndërmarrjen, njësi e përhershme e së cilës ajo është, në secilin shtet kontraktues do t'i atribuohen atij vendqëndrimi të përhershëm.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një njësie të përhershme, lejohen si zbritje shpenzimet që janë bërë për qëllime të njësisë së përhershme, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative të bëra, qoftë në shtetin ku ndodhet njësi e përhershme, ose diku tjetër.

4. Asnjë fitim nuk i atribuohet një njësie të përhershme vetëm për shkak të blerjes nga ajo njësi e përhershme të mallrave për ndërmarrjen.

5. Për qëllime të paragrafëve të mësipërm, fitimet që i atribuohen njësisë së përhershme, përcaktohen me anë të së njëjtës metodë vit pas viti, për sa kohë që nuk ka arsye të fortë dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

6. Për sa kohë që është e zakonshme në një shtet kontraktues të përcaktohen fitimet që i atribuohen një njësie të përhershme mbi bazën e një ndarjeje të fitimeve totale të ndërmarrjes në pjesë të ndryshme, asgjë në paragrafin 2 nuk përjashton atë shtet kontraktues nga përcaktimi i fitimeve që do të taten nga kjo ndarje, siç mund të jetë e zakonshme; megjithatë, metoda e zbatuar për ndarjet do të jetë e tillë që rezultati të jetë në pajtim me parimet në përmbajtje të këtij neni.

7. Kur fitimet përfshijnë zërat e të ardhurave ose fitimeve kapitale që rregullohen veçmas në nenet e tjera të kësaj marrëveshjeje, dispozitat e atyre neneve nuk do të cenohen nga dispozitat e këtij neni.

#### Neni 8

#### **Transporti me anije dhe avion**

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues nga operimi i anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

2. Për qëllimet e këtij neni, fitimet e nxjerra nga operimi i anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar përfshijnë:

a) fitimet që rrjedhin nga dhënia me qira e anijeve ose avionëve bosh; dhe

b) fitimet nga përdorimi, mirëmbajtja ose dhënia me qira e kontejnerëve (duke përfshirë rimorkiot dhe pajisjet përkatëse për transportin e kontejnerëve), të përdorura për transportin e mallrave; nëse kjo qira, ky përdorim, mirëmbajtje ose dhënie me qira, sipas rastit, lidhet me operimin e anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen, gjithashtu, për fitimet nga pjesëmarrja në një ortakëri, biznes të përbashkët ose agjenci operuese ndërkombëtare.

#### Neni 9

#### **Ndërmarrjet e asociuara**

1. Nëse:

a) një ndërmarrje e një shteti kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues; ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues dhe një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues,

dhe kur në çdo rast janë caktuar ose vendosur kushte ndërmjet dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare që ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim, që në mungesë të atyre kushteve, do t'i ishte shtuar një prej ndërmarrjeve, por për shkak të atyre kushteve nuk është shtuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe rrjedhimisht të tatohet.

2. Kur një shtet kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij shteti - dhe rrjedhimisht taton - fitimet për të cilat një ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues është tatuar në atë shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitimet, të cilat do t'i ishin shtuar ndërmarrjes së shtetit të përmendur së pari, nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve do të kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm ndaj sasisë së tatimeve të vendosura në të mbi ato fitime. Në përcaktimin e kësaj përshtatjeje, duhet t'u kushtohet vëmendje dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, sipas rastit, konsultohen me njëri-tjetrin.

#### Neni 10

#### **Dividendët**

1. Dividendët e paguar nga një firmë që është rezidente e një shteti kontraktues ndaj një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të tatohen, gjithashtu, në shtetin kontraktues në të cilin është rezidente firma që paguan dividendët dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon:

a) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve, nëse pronari përfitues është një shoqëri që ka drejtpërdrejt të paktën 25 për qind të kapitalit të shoqërisë që paguan dividendët ose është një skemë pensionesh;

b) në bazë të nënparagrafit "a", 15 për qind të shumës bruto të dividendëve nëse ata dividendë paguhet nga të ardhurat (duke përfshirë fitimet) të përfuara drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë nga



pasuria e paluajtshme brenda kuptimit të nenit 6 nga një instrument investimi që e shpërndan pjesën më të madhe të këtyre të ardhurave çdo vit dhe të ardhurat e të cilit nga kjo pasuri e paluajtshme janë përjashtuar nga tatimi;

c) 10 për qind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Ky paragraf nuk cenon tatimin e shoqërisë në lidhje me fitimet nga të cilat paguhen dividendët.

3. Termi “dividendë”, siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga aksionet ose të drejta të tjera që nuk janë detyrime borxhi, që marrin pjesë në fitime, si dhe çdo artikull tjetër që i nënshtrohet të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e shtetit në të cilin firma që bën shpërndarjen është rezidente.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin shoqëria që paguan dividendët është rezidente, nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në të dhe që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët është efektivisht e lidhur me këtë njësi të përhershme. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7.

5. Kur një shoqëri, e cila është rezidente e një shteti kontraktues nxjerr fitime ose të ardhura nga shteti tjetër kontraktues, ai shtet tjetër nuk mund të vendosë ndonjë tatim mbi dividendët e paguar nga firma, përveç rasteve kur këta dividendë i paguhen një rezidenti të atij shteti tjetër ose për sa kohë që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët, është efektivisht e lidhur me njësinë e përhershme të vendosur në atë shtet tjetër, dhe as nuk do t'i nënshtrojë fitimet e pashpërndara të shoqërisë një tatimi mbi fitimet e pashpërndara, edhe nëse dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht prej fitimeve ose të ardhurave të nxjerra në atë shtet tjetër.

6. Asnjë masë mbrojtëse nuk ofrohet në bazë të këtij neni, nëse qëllimi kryesor ose një nga qëllimet kryesore të një personi të përfshirë në krijimin ose transferimin e aksioneve ose të drejtave të tjera në lidhje me të cilat paguhet dividendi, është për të përfituar nga ky nen nëpërmjet krijimit ose transferimit.

## Neni 11

### Interesi

1. Interesi i nxjerrë në një shtet kontraktues dhe i paguar një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatóhet në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, ky interes mund të tatóhet në shtetin kontraktues në të cilin ai lind dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i interesit është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon 6 për qind të shumës bruto të interesit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesi i përmendur në paragrafin 1 është i tatuashëm vetëm në shtetin kontraktues, shtetas i të cilit është përfituesi, nëse pronari përfitues i interesit është rezident i atij shteti, dhe:

a) është ai shtet ose bankë qendrore, një nënndarje politike ose autoritet lokal i tij;

b) nëse interesi paguhet nga shteti në të cilin lind interesi ose nga një nënndarje politike ose autoritet lokal i tij;

c) nëse interesi paguhet në lidhje me një hua, detyrim borxhi ose kredi që duhet t'i paguhet, ose që krijohet, jepet, garantohet ose sigurohet nga ai shtet ose një nënndarje politike, ose autoritet lokal, ose agjenci financimi eksporti e tij;

d) është një institucion financiar;

e) nëse interesi paguhet në lidhje me një borxh, që lind si pasojë e shitjes me kredi të një pajisjeje, malli ose shërbimi; ose

f) është një skemë pensioni.

2. Termi “interes”, siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga detyrimet e borxhit të çdo lloji, i garantuar apo jo me hipotekë dhe nëse ka apo jo të drejtë për të marrë pjesë në fitimet e debitorit dhe, në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë qeveritare dhe të ardhurat nga obligacionet ose dëftesat e borxhit, duke përfshirë premiet dhe çmimet që u bashkëngjiten këtyre letrave me vlerë, obligacioneve dhe dëftesave të borxhit. Gjohet për vonesat në pagesa nuk llogariten si interes për qëllimet e këtij neni. Termi nuk përfshin asnjë artikull që trajtohet si dividend sipas dispozitave të nenit 10.

3. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i interesit, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin lind interesi, nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në të dhe detyrimi i borxhit në lidhje me të cilin është paguar interesi, është efektivisht i lidhur me këtë njësi të përhershme. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7.

4. Interesi konsiderohet të lindë në një shtet kontraktues kur paguesi është rezident i atij shteti. Megjithatë, nëse personi që paguan interesin, qoftë rezident i shtetit kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues një njësi të përhershme në lidhje me të cilën ka ndodhur mbetja e borxhit mbi të cilën është paguar interesi dhe ky interes përballohet nga kjo njësi e përhershme, atëherë interesi konsiderohet të lindë në shtetin në të cilin ndodhet njësia e përhershme.

5. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shumën e interesit të paguar, për çfarëdo arsye, tejkalon shumën, e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke i kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje.

6. Asnjë masë mbrojtëse nuk ofrohet në bazë të këtij neni, nëse qëllimi kryesor ose një nga qëllimet kryesore të një personi të përfshirë në krijimin ose transferimin e detyrimeve të borxhit në lidhje me të cilat paguhet interesi, është për të përfituar nga ky nen nëpërmjet krijimit ose transferimit.

#### Neni 12

#### **Tarifat e licencave**

1. Tarifat e licencave që lindin në një shtet kontraktues dhe të përftuara në pronësi nga një rezident i shtetit tjetër kontraktues, taten vetëm në atë shtet tjetër.

2. Termi “tarifat e licencave”, siç përdoret në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte autori të veprës letrare, artistike ose shkencore, duke përfshirë filmat kinematografikë, çdo patentë, markë tregtare, dizajno ose model, plan, formulë ose proces sekret, ose për informacion (ekspertizë) në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

3. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i tarifave të licencave, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin lindin tarifat e licencave, nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në të dhe e drejta ose pasuria në lidhje me të cilat paguhet tarifat e licencave, është e lidhur efektivisht me këtë njësi të përhershme. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7.

4. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shumën e tarifave të licencave të paguara, për çfarëdo arsye, tejkalon shumën, e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke u kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje.

5. Asnjë masë mbrojtëse nuk ofrohet në bazë të këtij neni, nëse qëllimi kryesor ose një nga qëllimet kryesore të një personi të përfshirë në krijimin ose transferimin e të drejtave në lidhje me të cilat paguhet tarifat e licencave, është për të përfituar nga ky nen nëpërmjet krijimit ose transferimit.

#### Neni 13

#### **Fitimet kapitale**

1. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një shteti kontraktues, nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme, të përmendur në nenin 6 dhe të ndodhur në shtetin tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Fitimet e përftuara nga një rezident i një shteti kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve të ndryshme nga aksionet për të cilët ka një tregtim të rregullt dhe të qenësishëm në bursë, ose interesa të krahasueshme, që marrin më shumë se 50 për qind të vlerës së tyre drejtpërdrejt ose në mënyrë të



tërthortë nga pasuria e paluajtshme, që gjendet në shtetin tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme, që përbëjnë pjesë të pronës së biznesit të një njësie të përhershme, që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues, duke përfshirë fitimet nga tjetërsimi i kësaj njësie të përhershme (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen), mund të taten në atë shtet tjetër.

4. Fitimet e një rezidenti të një shteti kontraktues nga tjetërsimi i anijeve ose i avionëve të operuar në trafikun ndërkombëtar nga një ndërmarrje e atij shteti, ose pasurisë së luajtshme që i përket operimit të këtyre anijeve ose avionëve, janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo prone, të ndryshme nga ajo e përmendur në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, janë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues, rezidenti i të cilit është tjetërsuesi.

#### Neni 14

##### **Të ardhurat nga punësimi**

1. Në bazë të dispozitave të nenit 15, 17 dhe 18, rrogat, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme, që përfitohen nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim, janë të tatueshme vetëm në atë shtet, nëse punësimi nuk ushtrohet në shtetin tjetër kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet në këtë mënyrë, ky shpërblim që përfitohet atje mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimi i përftuar nga një rezident i një shteti kontraktues, në lidhje me një punësim të ushtruar në shtetin tjetër kontraktues, është i tatueshëm vetëm në shtetin e përmendur së pari, nëse:

a) përfituesi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore, e cila fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës; dhe

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi, i cili nuk është rezident i shtetit tjetër; dhe

c) shpërblimi nuk përballohet nga një njësi e përhershme, të cilën punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij neni, shpërblimi i përftuar nga një rezident i një shteti kontraktues, në lidhje me një punësim të ushtruar në bordin e një anijeje ose avioni të operuar në trafikun ndërkombëtar, taten vetëm në atë shtet.

#### Neni 15

##### **Tarifat e drejtuesve**

Tarifat e drejtuesve dhe pagesa të tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një shteti kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtuesve ose organi të ngjashëm të një shoqërie, e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

#### Neni 16

##### **Artistët dhe sportistët**

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 7 dhe 14, të ardhurat që përfitohen nga një rezident i një shteti kontraktues si argëtues, artist teatri, filmi, radioje ose televizioni, ose muzikant apo sportist, nga aktivitetet personale si të tilla, të ushtruara në shtetin tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale, të ushtruara nga një argëtues ose sportist, në cilësinë e tij të tillë, nuk përfitohen nga subjekti argëtues ose sportisti, por nga person tjetër, ato të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7 dhe 14, mund të taten në shtetin kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e argëtuesit apo sportistit.

Neni 17  
**Pensionet**

Pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme, që lindin në një shtet kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

Neni 18  
**Shërbimi qeveritar**

1. a) Rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të paguara nga një shtet kontraktues ose një nënndarje politike, ose autoritet lokal, një individ, në lidhje me shërbimet e kryera për atë shtet ose nënndarje, ose autoritet, janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto rroga, paga dhe shpërblime të tjera të ngjashme janë të tatueshme vetëm në shtetin tjetër kontraktues, nëse shërbimet kryhen në atë shtet dhe nëse individ është rezident i atij shteti dhe, që:

i) është shtetas i atij shteti; ose

ii) nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

dhe u nënshtrohet tatimeve në atë shtet mbi pagesat, rrogat dhe shpërblimet e tjera.

2. Dispozitat e neneve 14, 15 dhe 16 zbatohen për rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme në lidhje me shërbimet e kryera për një biznes të zhvilluar nga një shtet kontraktues ose nënndarje e tij politike ose autoritet lokal i tij.

Neni 19  
**Studentët dhe stazhierët**

Nëse një student ose stazhier, i cili është ose ka qenë, menjëherë para vizitës në shtetin kontraktues, rezident i shtetit tjetër kontraktues dhe që është i pranishëm në shtetin e parë vetëm për qëllime të edukimit ose trajnimit të tij, asnjë pagesë që merret për qëllimet e mbështetjes ekonomike, edukimit ose trajnimit të tij nuk tatohet në atë shtet, me kusht që këto pagesa të lindin nga burime jashtë atij shteti.

Neni 20  
**Të ardhura të tjera**

1. Zërat e të ardhurave, të përfuara në pronësi nga një rezident i një shteti kontraktues, kudo që lindin, të patrajuara në nenet e mësipërme të kësaj marrëveshjeje, me përjashtim të të ardhurave të paguara nga fondet e besimit ose pasuritë e personave të vdekur gjatë administrimit, janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1, nuk zbatohen për të ardhurat me përjashtim të të ardhurave nga pasuria e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse pronari përfutës i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në të dhe e drejta ose pasuria në lidhje me të cilat paguhen të ardhurat është efektivisht e lidhur me atë njësi të përhershme. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7.

3. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë, ndërmjet rezidentit të përmendur në paragrafin 1 dhe një personi tjetër ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shumat e të ardhurave, të përmendura në atë paragraf tejkalon shumën, e cila do të ishte rënë dakord ndërmjet tyre, në mungesë të kësaj marrëdhënieje, zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e të ardhurave mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke u kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje.

4. Asnjë masë mbrojtëse nuk ofrohet në bazë të këtij neni, nëse qëllimi kryesor ose një nga qëllimet kryesore të një personi të përfshirë në krijimin ose transferimin e të drejtave në lidhje me të cilat paguhen të ardhurat, është për të përfituar nga ky nen nëpërmjet krijimit ose transferimit.





## Neni 21

### Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e luajtshme, e përmendur në nenin 6, në pronësi të një rezidenti të një shteti kontraktues dhe që gjendet në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e luajtshme, që përbën pjesë të pasurisë së biznesit të një njësie të përhershme që një ndërmarrje e shtetit kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anijet dhe avionët të operuar në trafikun ndërkombëtar nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues dhe nga pasuri e luajtshme, që i përket operimit të këtyre anijeve dhe avionëve, tatohet vetëm në atë shtet kontraktues.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një shteti kontraktues taten vetëm në atë shtet.

## Neni 22

### Shmangia e tatimit të dyfishtë

1. Në pajtim me dispozitat e ligjit të Mbretërisë së Bashkuar, në lidhje me lejimin si kredi ndaj tatimit në Mbretërinë e Bashkuar të tatimit të pagueshëm në një territor jashtë Mbretërisë së Bashkuar ose, sipas rastit, në lidhje me përjashtimin nga tatimi i Mbretërisë së Bashkuar të një dividendi në një territor jashtë Mbretërisë së Bashkuar (që nuk cenon parimin e përgjithshëm të tij):

a) Tatimi shqiptar që paguhet në pajtim me ligjet e Shqipërisë dhe në pajtim me këtë marrëveshje, drejtpërdrejt ose me zbritje, mbi fitimet, të ardhurat ose fitimet e tatueshme nga burime brenda Shqipërisë (duke përjashtuar në rastin e një tatimi mbi dividendin e pagueshëm në lidhje me fitimet nga të cilat paguhet dividendi), lejohet si kredi ndaj tatimit në Mbretërinë e Bashkuar, të llogaritur, duke iu referuar të njëjtëve fitime, të ardhurave ose fitimeve të tatueshme nëpërmjet referencës ku llogaritet tatimi shqiptar;

b) Një dividend që paguhet nga një shoqëri që është rezidente e Shqipërisë ndaj një shoqërie, që është rezidente e Mbretërisë së Bashkuar përjashtohet nga tatimi i Mbretërisë së Bashkuar, nëse përmbushen kushtet për përjashtim sipas ligjit të Mbretërisë së Bashkuar;

c) Në rastin e një dividendi që nuk përjashtohet nga tatimi, sipas nënparagrafit “b” të mësipërm (për shkak se nuk janë përmbushur kushtet për përjashtim sipas ligjit të Mbretërisë së Bashkuar), që paguhet nga një shoqëri që është rezidente e Shqipërisë, një shoqërie që është rezidente e Mbretërisë së Bashkuar dhe që kontrollon drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë të paktën 10 për qind të fuqisë votuese në shoqërinë që paguan dividendin, kredia e përmendur në nënparagrafin “a” të mësipërm merr, gjithashtu, përsipër tatimin shqiptar që paguhet nga shoqëria në lidhje me fitimet e saj nga të cilat paguhet ky dividend.

#### 2. Në Shqipëri:

a) Nëse një rezident i Shqipërisë përfton të ardhura ose ka në pronësi kapital që, në pajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, mund të taten në Mbretërinë e Bashkuar, Shqipëria lejon:

i) si zbritje nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat, të paguar në Mbretërinë e Bashkuar; dhe

ii) si zbritje nga tatimi shqiptar mbi kapitalin e atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin mbi kapitalin, të paguar në Mbretërinë e Bashkuar.

Megjithatë, kjo zbritje në çdo rast nuk tejkalon atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat ose kapitalin që llogariten para se të bëhet zbritja, që u përket, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të taten në Mbretërinë e Bashkuar.

b) Nëse në pajtim me një dispozitë të marrëveshjes, të ardhurat e përftuara ose kapitali në pronësi të një rezidenti të Shqipërisë përjashtohen nga tatimi në Shqipëri, Shqipëria sidoqoftë, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur të këtij rezidenti, merr parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

3. Për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2, fitimet dhe të ardhurat në pronësi të një rezidenti të një shteti kontraktues, që mund të taten në shtetin tjetër kontraktues në pajtim me këtë marrëveshje, konsiderohen të kenë rrjedhur nga burime në atë shtet tjetër.

#### Neni 23

### **Kufizimi i lirim**

Nëse në pajtim me një dispozitë të kësaj marrëveshjeje, të ardhurat ose fitimet lirohen nga tatimi në një shtet kontraktues dhe, sipas ligjeve në fuqi në shtetin tjetër kontraktues një person, në lidhje me ato të ardhura ose fitime i nënshtrohet tatimit duke iu referuar shumës që dërgohet ose merret në atë shtet tjetër dhe jo nëpërmjet referencës të shumës së plotë, lirimi që lejohet sipas kësaj marrëveshjeje në shtetin e parë, zbatohet vetëm në atë masë që të ardhurat dhe fitimet taten në shtetin tjetër.

#### Neni 24

### **Mosdiskriminimi**

1. Shtetasit e një shteti kontraktues nuk i nënshtrohen tatimit apo ndonjë kërkesë në lidhje me të në shtetin tjetër kontraktues, që është e ndryshme ose është më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat përkatëse, të cilave u nënshtrohen ose mund t'u nënshtrohen shtetasit e atij shteti tjetër në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me rezidencën.

2. Tatimi mbi një njësi të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues, nuk do të vendoset në mënyrë më pak të favorshme në atë shtet tjetër sesa tatimi i vendosur mbi ndërmarrjet e atij shteti tjetër që zhvillon të njëjtat aktivitete.

3. Përveç rasteve kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, të paragrafit 7 ose 8 të nenit 11 ose të paragrafit 4 ose 5 të nenit 12, ose paragrafit 3 ose 4 të nenit 20, interesi, tarifat e licencave dhe disburseime të tjera, të paguara nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues ndaj një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, për qëllim të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin paguar një rezidenti të shtetit të përmendur së pari. Po ashtu, çdo borxh i një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, për qëllimin e përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të një ndërmarrjeje të tillë, është i zbritshëm sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin kontraktuar një rezidenti të shtetit të përmendur së pari.

4. Ndërmarrjet e një shteti kontraktues, kapitali i të cilave është në pronësi ose zotërohet tërësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga një ose më shumë rezidentë të shtetit tjetër kontraktues, nuk i nënshtrohet asnjë tatimi ose kërkesë në lidhje me të në shtetin e përmendur së pari, që është e ndryshme ose më e rëndë se tatimi dhe kërkesat përkatëse, të cilave u nënshtrohen ose mund t'u nënshtrohen ndërmarrje të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur së pari.

5. Asgjë në këtë nen nuk interpretohet sikur detyron një shtet kontraktues t'u japë individëve jorezidentë të atij shteti ndonjë zbritje, lirim dhe ulje personale për qëllime tatimore që u jepet individëve rezidentë ose shtetasve të tij.

#### Neni 25

### **Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë**

1. Kur një person konsideron se veprimet e një ose të dy shteteve kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për të në tatim në mospajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, pavarësisht nga mjetet e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i atyre shteteve, ai mund t'ia paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të shtetit kontraktues në të cilin është rezident ose, nëse çështja e tij trajtohet në paragrafin 1 të nenit 24 të shtetit kontraktues në të cilin është shtetas. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetësh nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatimin në mospajtim me dispozitat e marrëveshjes.

2. Autoriteti kompetent, nëse i duket se kundërshtimi është i bazuar dhe nëse nuk është vetë në gjendje për të arritur një zgjidhje të pranueshme, përpiqet të zgjidhë çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë me autoritetin kompetent të shtetit tjetër kontraktues, me qëllim shmangien e tatimit që nuk është në pajtim me këtë marrëveshje. Çdo marrëveshje e arritur zbatohet pavarësisht afateve kohore ose kufizimeve të tjera procedurale në ligjin e brendshëm të shteteve kontraktuese, përveç kur këto kufizime zbatohen për pretendimet e ngritura në pajtim me një marrëveshje të tillë.



3. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese përpiqen të zgjidhin me anë të marrëveshjes së ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Ata, gjithashtu, mund të konsultohen së bashku për shmangien e tatimit të dyfishtë, në rastet të cilat nuk janë parashikuar në marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin në mënyrë të drejtpërdrejtë, për qëllim të arritjes së një marrëveshjeje, në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

5. Nëse:

a) Në bazë të paragrafit 1, një person ka paraqitur një çështje tek autoriteti kompetent i shtetit kontraktues për shkak se veprimet e një ose të dy shteteve kontraktuese kanë rezultuar për atë person në tatim në kundërshtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje; dhe

b) Autoritetet kompetente nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje për të zgjidhur çështjen në pajtim me paragrafin 2, brenda dy vjetëve, nga paraqitja e çështjes tek autoriteti kompetent i shtetit tjetër kontraktues;

Çdo problem i pazgjidhur që rrjedh nga çështja, paraqitet në arbitrazh, nëse personi e kërkon këtë. Megjithatë, këto probleme të pazgjidhura nuk paraqiten në arbitrazh nëse për to është dhënë një vendim nga një gjykatë ose organ administrativ i një shteti. Përveç kur personi i interesuar drejtpërdrejt në çështje nuk e pranon marrëveshjen e ndërsjellë që zbaton vendimin e arbitrazhit, ai vendim është detyrues për të dyja shtetet kontraktuese dhe zbatohet pavarësisht afateve kohore në ligjet e brendshme të këtyre shteteve. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, me marrëveshje të ndërsjellë, zgjidhin mënyrën e zbatimit të këtij paragrafi.

6. Dispozitat e paragrafit 5 nuk zbatohen për çështjet që rregullohen nga paragrafi 3 i nenit 4.

Neni 26

### **Shkëmbimi i informacionit**

1. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese shkëmbejnë atë informacion, që mendohet të jetë i nevojshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje ose për administrimin, ose zbatimin e ligjeve të brendshme të shteteve kontraktuese, në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimin e caktuar në emër të shteteve kontraktuese, ose të nënndarjeve të tyre politike, ose autoriteteve lokale, në masën që tatimi sipas tyre nuk është në kundërshtim me këtë marrëveshje, veçanërisht për të shmangur mashtrimin dhe për të lehtësuar administrimin e dispozitave ligjore ndaj evazionit fiskal. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë sipas paragrafit 1 nga një shtet kontraktues, trajtohet si i fshehtë në të njëjtën mënyrë si informacioni i përfutur sipas ligjeve të brendshme të atij shteti dhe u deklarohet vetëm personave ose autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative), që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin ose procedimin në lidhje me ose përcaktimin e ankimeve në lidhje me tatimet e përmendura në paragrafin 1, ose mbikëqyrjen e sa më sipër. Këta persona dhe këto autoritete e përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund ta deklarojnë informacionin në procedime gjyqësore me dyer të hapura ose në vendime gjyqësore. Pavarësisht sa më sipër, informacioni i marrë nga një shtet kontraktues mund të përdoret për qëllime të tjera nëse ky informacion mund të përdoret për qëllime të tjera sipas ligjeve të të dyja shteteve dhe autoriteti kompetent i shtetit zbatues e autorizon këtë përdorim.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 dhe 2, nuk interpretohen sikur vendosin mbi një shtet kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative në mospajtim me ligjet dhe praktikën administrative të tij ose të shtetit tjetër kontraktues;

b) të japin informacion që nuk është i përfutueshëm sipas ligjeve ose në punën normale të administrimit në atë ose shtetin tjetër kontraktues;

c) të japin informacion që do të zbulonte çdo sekret tregtar, biznesi, industrial ose profesional, ose proces tregtar apo informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike.

4. Nëse informacioni kërkohet nga një shtet kontraktues në pajtim me këtë nen, shteti tjetër kontraktues përdor masat e tij për mbledhjen e informacionit për të marrë informacionin e kërkuar, megjithëse atij shteti tjetër mund të mos i duhet ky informacion për qëllimet e tij tatimore. Detyrimi që gjendet në fjalinë e mësipërme i nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 3, por në asnjë rast këto kufizime nuk interpretohen sikur lejojnë një shtet kontraktues të refuzojë dhënien e informacionit thjesht pasi nuk ka interes të brendshëm për këtë informacion.

5. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 3 nuk interpretohen sikur lejojnë një shtet kontraktues të refuzojë dhënien e informacionit vetëm pasi informacioni mbahet nga një bankë, institucion tjetër financiar, i emëruar, ose person që vepron në një agjenci, ose cilësi mirëbesimi, ose pasi ka të bëjë me interesa pronësie të një personi.

#### Neni 27

#### Asistenca në mbledhjen e tatimeve

1. Shtetet kontraktuese i japin njëri-tjetrit asistencë në realizimin e pretendimeve për të ardhura. Kjo asistencë nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2 të kësaj marrëveshjeje. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, me marrëveshje të ndërsjellë, zgjidhin mënyrën e zbatimit të këtij neni.

2. Termi “pretendim për të ardhura”, që përdoret në këtë nen, nënkupton një shumë të pagueshme në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimin e vendosur në emër të shteteve kontraktuese, ose të nënndarjeve të tyre politike ose autoriteteve lokale, në masën që tatimi sipas tij nuk është në kundërshtim me këtë marrëveshje ose një instrument tjetër ku shtetet kontraktuese janë palë, si dhe interesi, gjambat administrative dhe shpenzimet e realizimit ose ruajtjes në lidhje me këtë shumë.

3. Nëse një pretendim për të ardhura i një shteti kontraktues është i zbatueshëm sipas ligjeve të atij shteti dhe është e pagueshme nga një person që, në atë moment, në bazë të ligjeve të atij shteti, nuk mund të pengojë realizimin, ky pretendim për të ardhura, me kërkesë të autoritetit kompetent të atij shteti, pranohet për qëllimet e realizimit nga autoriteti kompetent i shtetit tjetër kontraktues. Ai pretendim për të ardhura realizohet nga ai shtet tjetër në pajtim me dispozitat e ligjeve të zbatueshme për zbatimin dhe realizimin e tatimeve të veta, sikur pretendimi për të ardhura të ishte një pretendim për të ardhura të atij shteti tjetër.

4. Nëse një pretendim për të ardhura i një shteti kontraktues është një pretendim në lidhje me të cilin ai shtet, sipas ligjit të vet, mund të marrë masa ruajtjeje, me qëllim sigurimin e realizimit, ai pretendim për të ardhura, me kërkesë të autoritetit kompetent të atij shteti, pranohet për qëllimet e marrjes së masave të ruajtjes nga autoriteti kompetent i shtetit tjetër kontraktues. Ai shtet tjetër merr masat e ruajtjes në lidhje me atë pretendim për të ardhura në pajtim me dispozitat e ligjit të vet sikur pretendimi për të ardhura të ishte një pretendim për të ardhura i atij shteti tjetër edhe nëse, në momentin kur zbatohen masat, pretendimi për të ardhura nuk është i zbatueshëm në shtetin e përmendur së pari ose është i pagueshëm nga një person që ka një të drejtë për të shmangur realizimin.

5. Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni, një pretendim për të ardhura, i pranuar nga një shtet kontraktues për qëllimet e paragrafëve 3 ose 4, në atë shtet, nuk u nënshtrohet afateve kohore apo t’i jepet prioritet që zbatohet për një pretendim për të ardhura sipas ligjeve të atij shteti për shkak të natyrës së tij si i tillë. Përveç kësaj, një pretendim për të ardhura, i pranuar nga një shtet kontraktues për qëllimet e paragrafëve 3 ose 4, nuk ka prioritet që zbatohet për atë pretendim për të ardhura sipas ligjeve të shtetit tjetër kontraktues.

6. Procedimet në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose shumën e pretendimit të të ardhurave të një shteti kontraktues nuk paraqiten para gjykatave ose organeve administrative të shtetit tjetër kontraktues.

7. Nëse në një moment, pasi të jetë bërë një kërkesë nga një shtet kontraktues, sipas paragrafit 3 ose 4 të këtij neni dhe para se shteti tjetër kontraktues të ketë realizuar dhe dërguar pretendimin përkatës për të ardhura të shteti i përmendur së pari, pretendimi përkatës për të ardhura pushon së qeni:

a) në rastin e një kërkesë sipas paragrafit 3, një pretendim për të ardhura i shtetit të përmendur së pari që është i zbatueshëm sipas ligjeve të atij shteti dhe që është i pagueshëm nga një person që, në atë moment, nuk mund të pengojë realizimin e tij sipas ligjeve të atij shteti; ose



b) në rastin e një kërkesë sipas paragrafit 4, një pretendim për të ardhura i shtetit të përmendur së pari në lidhje me të cilin ai shtet, sipas ligjeve të veta, mund të marrë masat e ruajtjes, me qëllim sigurimin e realizimit,

autoriteti kompetent i shtetit të përmendur së pari njofton menjëherë autoritetin kompetent të shtetit tjetër për atë fakt dhe, sipas zgjedhjes së shtetit tjetër, shteti i përmendur së pari pezullon ose tërheq kërkesën e tij.

8. Në asnjë rast, dispozitat e këtij neni nuk interpretohen sikur vendosin një detyrim mbi një shtet kontraktues:

a) për të zbatuar masa administrative në kundërshtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij ose të shtetit tjetër kontraktues;

b) të zbatojë masa që do të ishin në kundërshtim me politikën publike;

c) të japë asistencë nëse shteti tjetër kontraktues nuk ka ndjekur të gjitha masat e arsyeshme për realizimin ose ruajtjen, sipas rastit, të mundshme sipas ligjeve ose praktikave administrative të veta;

d) të japë asistencë në ato raste kur barra administrative për atë shtet është haptazi joproporcionale me përfitimin që merret nga shteti tjetër kontraktues;

e) të japë asistencë nëse ai shtet konsideron që tatimet, në lidhje me të cilat kërkohet asistenca, janë vendosur në kundërshtim me parimet tatimore përgjithësisht të pranuar.

#### Neni 28

#### **Anëtarët e misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore**

Asgjë në këtë marrëveshje nuk cenon privilegjet fiskale të anëtarëve të misioneve diplomatike ose zyrave konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

#### Neni 29

#### **Hyrja në fuqi**

1. Secili shtet kontraktues njofton tjetrin, nëpërmjet kanaleve diplomatike, mbi përfundimin e procedurës së kërkuar nga ligji i vet për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit dhe pas kësaj mbetet në fuqi:

a) në Shqipëri, në lidhje me të ardhurat e përfuara ose kapitalin në pronësi, në ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik menjëherë pas vitit në të cilin kjo marrëveshje hyn në fuqi.

b) në Mbretërinë e Bashkuar:

i) në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe tatimin mbi fitimet kapitale, për çdo vit të vlerësimit që fillon në ose pas datës 6 prill menjëherë pas datës në të cilën kjo marrëveshje hyn në fuqi;

ii) në lidhje me tatimin e shoqërive, për çdo vit financiar, që fillon në ose pas datës 1 prill menjëherë pas datës në të cilën kjo marrëveshje hyn në fuqi; dhe

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1, dispozitat e nenit 26 (shkëmbimi i informacionit) kanë fuqi nga data në të cilën kjo marrëveshje hyn në fuqi pa marrë parasysh periudhën tatimore me të cilën ka lidhje informacioni.

#### Neni 30

#### **Përfundimi**

Kjo marrëveshje mbetet në fuqi deri sa të prishet nga një prej shteteve kontraktuese. Secili shtet kontraktues mund ta prishë këtë marrëveshje, nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke bërë njoftim për prishjen të paktën gjashtë muaj para fundit të çdo viti kalendarik, që fillon pas skadimit të një periudhe pesëvjeçare nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Në një rast të tillë, marrëveshja pushon së qeni në fuqi:

a) në Mbretërinë e Bashkuar:

i) në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe tatimin mbi fitimet kapitale, për çdo vit të vlerësimit, që fillon në ose pas datës 6 prill menjëherë pas datës në të cilën bëhet njoftimi;

ii) në lidhje me tatimin e shoqërive, për çdo vit financiar, që fillon në ose pas datës 1 prill menjëherë pas datës në të cilën bëhet njoftimi; dhe

b) në Shqipëri, në lidhje me të ardhurat e përfuara ose kapitalin në pronësi, në ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik menjëherë pas vitit në të cilin bëhet njoftimi.

Bërë në dy kopje në Tiranë, më 26 mars 2013, në gjuhët shqip dhe anglisht ku të dyja tekstet janë njëllorj autentike.

#### PROTOKOLL

Në momentin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, të lidhur sot ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe të poshtëshënuarit kanë rënë dakord që dispozitat e mëposhtme të jenë pjesë përbërëse e marrëveshjes.

1. Në lidhje me nenet 10 dhe 11:

Kuptohet që termi “skemë pensioni” përfshin sa më poshtë dhe çdo skemë të njëjtë ose thelbësisht të ngjashme, që krijohet në pajtim me legjislacionin e miratuar pas datës së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje:

a) në rastin e Shqipërisë, skemat e pensionit (të ndryshme nga skema e sigurimeve sociale), siç përkufizohet në pajtim me legjislacionin shqiptar në fuqi;

b) në rastin e Mbretërisë së Bashkuar, skemat e pensioneve (të ndryshme nga skema e sigurimeve sociale), të regjistruara sipas pjesës 4 të ligjit të financave 2004, duke përfshirë skemat e pensionit, të rregulluara nëpërmjet shoqërive të sigurimeve dhe fondeve të besimit, ku zotëruesit e fondeve të besimit janë ekskluzivisht skema pensionesh.

2. Në lidhje me nenin 4:

Kuptohet që termi “rezident i një shteti kontraktues” përfshin:

a) një skemë pensioni të ngritur në atë shtet; dhe

b) një organizatë, që është ngritur dhe operohet ekskluzivisht për qëllime fetare, bamirësie, shkencore, kulturore ose edukative (ose për më shumë se një prej këtyre qëllimeve) dhe që është rezidente e atij shteti në pajtim me ligjet e tij, pavarësisht nëse të gjitha apo një pjesë e të ardhurave ose fitimeve të saj mund të përjashtohen nga tatimi në pajtim me ligjet e brendshme të atij shteti.

3. Në lidhje me nenin 7:

Kuptohet që pagesat për përdorimin e pajisjeve industriale, tregtare ose shkencore përfshihen në trajtimin e nenit 7 dhe jo nenit 6.

Bërë në dy kopje në Tiranë, më 26 mars 2013, në gjuhët shqip dhe anglisht, ku të dyja tekstet janë njëllorj autentike.

#### LIGJ

Nr. 174/2013

### **PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË NDIHMËS PËR OBJEKTIVA ZHVILLIMI NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS, QEVERISJEN E MIRË DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR NJË RITJE EKONOMIKE ME BAZË TË GJERË, TË QËNDRUESHME DHE GJITHËPËRFSHIRËSE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për forcimin e shtetit të së



drejtës, qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 5.12.2013

## **Shpallur me dekretin nr. 8442, datë 24.12.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

Marrëveshje ndihme e USAID-it nr. 182-DOAG-13-001

### **MARRËVESHJE NDIHME PËR OBJEKTIVA ZHVILLIMI**

**NDËRMJET QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË “PËR FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS DHE QEVERISJEN E MIRË DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR NJË RITJE EKONOMIKE ME BAZË TË GJERË DHE TË QËNDRUESHME”**

Datë: 30 shtator 2013

Marrëveshje ndihme për objektiva zhvillimi ndërmjet qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës që vepron nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave (më poshtë e quajtur “Përfituesi i Ndhmës”).

Neni 1

#### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje ndihme për objektiva zhvillimi (marrëveshja) është vendosja e mirëkuptimit ndërmjet palëve të përmendura më sipër (palët) në lidhje me objektivat e zhvillimit të përshkruara më poshtë.

Neni 2

#### **Objektivat e zhvillimi dhe rezultatet**

Seksioni 2.1. Objektivat e zhvillimit. Objektivat e zhvillimit (objektivat) janë: Forcimi i shtetit të së drejtës dhe qeverisjes së mirë dhe krijimi i kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme.

Seksioni 2.2. Rezultatet. Me qëllim arritjen e këtyre objektive, palët bien dakord të punojnë së bashku për të arritur rezultatet e mëposhtme:

OZH# 1 Forcimi i shtetit të së drejtës dhe i qeverisjes së mirë

- Përmirësimi i një mjedisi favorizues për reformën në politika dhe planifikimin në qeverisjen vendore, drejtësi dhe shëndetësi;

- Nxitja e mbikëqyrjes qytetare dhe qeverisjes vendore transparente, drejtësisë dhe shëndetësisë;

- Rritje e cilësisë të kryerjes së punës dhe aftësive menaxhuese në qeverisje vendore, drejtësi dhe shëndetësi.

OZH #2 Krijimi i kushteve për rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme.

- Rritja e mundësive për sektorin privat, për shqiptarët dhe për të kthyerit nga vendet e eurozonës;

- Përmirësimi i kushteve për rritjen e drejtuar nga sektori privat;

- Fuqizimi i konkurrueshmërisë së sektorit privat.

Brenda kufijve të përkufizimit të objektivit në seksionin 2.1, ky seksion 2.2 mund të ndryshojë me anë të marrëveshjes me shkrim nga ana e përfaqësuesve të autorizuar të palëve, pa amendim formal të kësaj marrëveshjeje.

Seksioni 2.3. Shtojca 1, Përshkrimi i zgjeruar. Shtojca 1 bashkëlidhur plotëson objektivat dhe rezultatet e mësipërme. Brenda kufijve të përkufizimit të mësipërm të objektive në seksionin 2.1,

shtojca 1 mund të ndryshohet me marrëveshjeje me shkrim të përfaqësuesve të autorizuar të palëve, pa amendim formal të kësaj marrëveshjeje.

#### Neni 3

#### **Kontributet e palëve**

##### Seksioni 3.1. Kontributi i USAID-it

a) Granti. Për të ndihmuar arritjen e objektivave të parashtruar në këtë marrëveshje, USAID-i, sipas aktit të ndihmës së huaj të vitit 1961, i ndryshuar, i jep Përfituesit të Ndihmës, sipas kushteve të marrëveshjes, një shumë që nuk tejkalon nëntë milionë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë dollarë amerikanë (USD) (\$9,906,291) (granti).

b) Kontributi total i llogaritur i USAID-it. Kontributi total i llogaritur i USAID-it për arritjen e objektivave do të jetë njëzet e tetë milionë e pesëqind e dyzet e katër mijë dollarë amerikanë (\$28,544,000), të cilat do të jepen në mënyrë shtuese dhe në bazë të disponueshmërisë së fondeve. Rritjet pasuese do të jenë të kushtëzuara nga disponueshmëria e fondeve të USAID-it për këtë qëllim dhe mund të jepen nga USAID-i pas njoftimit me shkrim dërguar Përfituesit të Ndihmës. Palët bien dakord që çdo kontribut shtesë i dhënë, sipas rastit, do të rritë në mënyrë shtuese sasinë totale të ndihmës së përcaktuar në seksionin 3.1 (a). Pas kësaj Përfituesi i Ndihmës bie dakord të konfirmojë, me anë të njoftimit me shkrim dërguar USAID-it, këtë kontribut shtesë, nëse ka të tillë.

c) Nëse në çdo kohë USAID-i përcakton se kontributi i tij sipas seksionit 3.1 (a) tejkalon shumën që mund të përdoret në mënyrë të arsyeshme për arritjen e objektivave ose të rezultateve, ose aktiviteteve gjatë vitit fiskal amerikan, aktual ose të ardhshëm, USAID-i, pas njoftimit me shkrim dërguar Përfituesit të Ndihmës, mund të tërheqë shumën e tepërt, duke zvogëluar në këtë mënyrë shumën e ndihmës së parashikuar në seksionin 3.1 (a). Veprimet e ndërmarra në bazë të këtij nënseksioni nuk rishikojnë shumën totale të llogaritur të kontributit të USAID-it, të përcaktuar në pikën 3.1 (b).

Seksioni 3.2. Kontributi i Përfituesit të Ndihmës. Përfituesi i Ndihmës bie dakord të sigurojë ose se do të marrë masa që të sigurohen të gjitha fondet (përveç atyre të siguruara nga USAID-i ose nga ndonjë donator tjetër që përcaktohet në shtojcën 1) dhe të gjitha burimet të tjera që nevojiten për përfundimin, në ose para datës së përfundimit, e të gjitha aktiviteteve të nevojshme për arritjen e rezultateve.

#### Neni 4

#### **Data e përfundimit**

a) Data e përfundimit që është 30 shtatori 2016 ose ndonjë datë tjetër që mund të bihet dakord me shkrim nga palët, është data deri në të cilën palët vlerësojnë se do të përfundohen të gjitha aktivitetet e nevojshme për arritjen e objektivave dhe rezultateve.

b) Përveç rasteve kur USAID-i mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim, USAID-i nuk do të lëshojë ose nuk do të miratojë dokumentacion që do të autorizonte disbursimin e ndihmës për shërbime të kryera ose për mallra të furnizuara pas datës së përfundimit.

c) Kërkesat për disbursim, të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm mbështetës të përshkruar në letrat e zbatimit, duhet të merren nga USAID-i jo më vonë se nëntë (9) muaj pas datës së përfundimit, ose në një periudhë tjetër, ashtu si USAID-i bie dakord me shkrim para ose pas kësaj periudhe. Pas një periudhe të tillë, USAID-i, në çdo kohë mund t'i japë njoftim me shkrim Përfituesit të Ndihmës dhe të zvogëlojë shumën e ndihmës, në të gjithë ose në pjesë të saj, kërkesat për disbursimin e së cilës, të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm mbështetës të përshkruar në letrat e zbatimit, nuk merren para mbarimit të kësaj periudhe.

#### Neni 5

#### **Kushtet që i paraprijnë disbursimit**

Seksioni 5.1. Disbursimi i parë. Para disbursimit të parë sipas ndihmës ose para lëshimit nga ana e USAID-it të dokumentacionit në përputhje me të cilin do të kryhet ky disbursim, Përfituesi i Ndihmës, përveç rasteve kur palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim, do t'i japë USAID-it në formën dhe në përmbajtjen e pranueshme për USAID-in:





a) Një opinion ligjor të pranueshëm për USAID-in që kjo marrëveshje: i) është autorizuar ose ratifikuar dhe nënshkruar në mënyrën e duhur në emër të Përfituesit të Ndhmës; dhe ii) përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërisht detyrues të Përfituesit të Ndhmës në përputhje me të gjitha kushtet e saj; dhe iii) të gjitha veprimet dhe miratimet e brendshme, të nevojshme për të bërë të vlefshme këtë marrëveshje, janë marrë nga ose në emër të Përfituesit të Ndhmës; dhe

b) Një deklaratë të nënshkruar në emrin e personit që është në detyrën ose që vepron në funksionin e Përfituesit të Ndhmës të specifikuar në seksionin 7.2, që emëron me emër dhe titull çdo përfaqësues shtesë që mund të veprojë në përputhje me seksionin 7.2.

Seksioni 5.2. Njoftimi. USAID-i njofton menjëherë Përfituesin e Ndhmës nëse USAID-i ka përcaktuar se janë plotësuar kushtet paraprirëse.

Seksioni 5.3. Datat përfundimtare për kushtet paraprirëse. Data përfundimtare për plotësimin e kushteve të specifikuara në seksionin 5.1, është nëntëdhjetë (90) ditë nga data e kësaj marrëveshjeje ose një datë e mëvonshme që vendoset sipas miratimit me shkrim të USAID-it përpara ose pas datës përfundimtare si më sipër. Nëse kushtet paraprirëse në seksionin 5.1 nuk janë plotësuar deri në datën përfundimtare si më sipër, USAID-i, në çdo kohë, mund ta zgjidhë marrëveshjen me anë të një njoftimi me shkrim dërguar Përfituesit të Ndhmës.

#### Neni 6

#### **Marrëveshje të posaçme**

a) Përfituesi i Ndhmës bie dakord që kjo marrëveshje dhe ndihma e ofruar si më poshtë janë në përputhje me marrëveshjen ndërmjet qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për sa i përket ndihmës ekonomike, teknike dhe ndihmës tjetër të ngjashme, datë 10 qershor 1992 (marrëveshja ekonomike dypalëshe). Të gjitha dispozitat e marrëveshjes ekonomike dypalëshe, duke përfshirë, por pa u kufizuar te përjashtimet nga taksat, tatimet, tarifatat doganore e tarifa të tjera, zbatohen për fondet e disbursuara në lidhje me këtë marrëveshje. Asgjë në këtë marrëveshje nuk synon t'i shtrijë përjashtimet e mësipërme në ndonjë ndihmë specifike të pambuluar si nga marrëveshja ekonomike dypalëshe, ashtu dhe nga kjo marrëveshje. Mekanizmi për zbatimin e përjashtimeve do të specifikohet në dokumentet e zbatimit, sipas nenit A, seksionit A.2 të dispozitave standarde.

b) Përfituesi i Ndhmës, së bashku me ministritë dhe zyrat përkatëse të qeverisë së Shqipërisë, angazhohet dhe bie dakord të lëshojë, të rinovojë dhe/ose të shtyjë, pa pagesë dhe në kohën e duhur, të gjitha lejet zyrtare, vizat, përjashtimet dhe leje të tjera (duke përfshirë të gjitha miratimet që mund të kërkohen herë pas here, për të garantuar akses të plotë në informacion, në vendndodhjen e projektit dhe zyrat përkatëse) për personat përkatës (siç përcaktohet më poshtë), të cilët kryejnë aktivitetet e financuara nga USAID-i sipas kësaj marrëveshjeje (bashkërisht të quajtura "Dokumentet e kërkuara"). Për qëllimet e kësaj dispozite, personat përkatës përkufizohen, si: i) punonjësit dhe konsulentët e çdo kontraktori, Përfituesit të Ndhmës, organizate tjetër, që kryejnë aktivitete të financuara nga USAID-i sipas kësaj marrëveshjeje; dhe ii) anëtarët e familjeve të këtyre punonjësve dhe konsulentëve. Çdo rinovim ose shtyrje e këtyre dokumenteve të kërkuara, që kërkohen ose që bëhen të kërkuara, në mënyrë që këta punonjës, konsulentë dhe anëtarët e familjeve në ngarkim të tyre të qëndrojnë ligjërisht në Shqipëri dhe të ndërmarrin aktivitetet e parashikuara dhe të financuara sipas kësaj marrëveshjeje, lëshohet, gjithashtu, pa pagesë.

c) Përfituesi i Ndhmës, së bashku me ministritë dhe me zyrat përkatëse të qeverisë së Shqipërisë, me anë të këtyre marrëveshjeve të posaçme angazhohet dhe bie dakord të mbështetë investimet e financuara nga USAID-i sipas kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë, pa kufizim, investimet që lidhen me projektet e mëposhtme: Mundësimi i reformës së drejtë në shëndetësi; telemjekësia dhe shëndetësia elektronike në Shqipëri; projekti i forcimit të sektorit të drejtësisë Shqiptare; projekti i zhvillimit të sektorit financiar; dhe programi i planifikimit dhe qeverisjes vendore. Ky detyrim vazhdon të ekzistojë pas zgjidhjes së kësaj marrëveshjeje.

Neni 7  
**Të ndryshme**

Seksioni 7.1. Komunikimet. Çdo njoftim, kërkesë, dokument ose komunikim tjetër që secila palë i dorëzon palës tjetër sipas kësaj marrëveshjeje, do të jetë me shkrim ose me anë të telefaksit ose me postë elektronike (e-mail), dhe do të konsiderohet i dhënë ose i dorëzuar në mënyrën e duhur, nëse i dërgohet asaj pale në adresën e mëposhtme:

Për USAID-in:

Adresa postare:

Drejtorit të misionit

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Rruga e Elbasanit, nr. 103

Tiranë, Shqipëri

Telefaks: +355-4-366-394

Për Përfituesin e Ndihmës:

Adresa postare:

Ministri Shkëlqim Cani

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Telefaks: +355-4-228-405/494

Të gjitha këto komunikime do të jenë në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, me përjashtim të rasteve kur palët bien dakord ndryshe me shkrim. Adresa të tjera mund të zëvendësojnë adresat e mësipërme, pas dorëzimit të njoftimit. Në rast paqartësie ose konflikti midis dy versioneve, mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Seksioni 7.2. Përfaqësuesit. Për të gjitha qëllimet që lidhen me këtë marrëveshje, Përfituesi i Ndihmës do të përfaqësohet nga individ i cili ka pozicionin ose vepron si ministër i Financave, dhe USAID-i do të përfaqësohet nga individ i cili ka pozicionin ose vepron si drejtor i misionit të USAID-it/Shqipëri, ku çdonjëri prej tyre, me anë të një njoftimi me shkrim, mund të caktojë përfaqësues shtesë për të gjitha veprimet, me përjashtim të nënshkrimit të amendimeve zyrtare të marrëveshjes. Emrat dhe pozicionet e përfaqësuesve shtesë të Përfituesit të Ndihmës jepen në bazë të seksionit 5.1.(b), USAID-it, i cili mund të pranojë si të autorizuar në mënyrën e duhur çdo instrument të nënshkruar nga këta përfaqësues shtesë (ose nga cilido individ që mban ose vepron në detyrën e këtyre përfaqësuesve), në përputhje me seksionin 7.2 deri në marrjen e njoftimit me shkrim të revokimit të autoritetit të tyre.

Seksioni 7.3. Shtojca e dispozitave standarde. Një “Shtojcë e dispozitave standarde” (shtojca 2) i bashkëlidhet dhe bëhet pjesë e kësaj marrëveshjeje.

Seksioni 7.4. Gjuha e marrëveshjes. Kjo marrëveshje është përgatitur në gjuhën angleze dhe shqipe. Në rast paqartësie ose konflikti midis dy versioneve, mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Në dëshmi të kësaj, qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Përfituesi i Ndihmës, secili duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të vet të autorizuar rregullisht, kanë bërë që kjo marrëveshje të nënshkruhet në emrat e tyre dhe të dorëzohet në ditën dhe në vitin e cituar më sipër.

QEVERIA E SHTETEVE TË BASHKUARA  
TË AMERIKËS

Nga: \_\_\_\_\_

Datë: 30.9.2013

Emri: Jim Barnhart

Pozicioni: Drejtor i misionit USAID/Shqipëri

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË

Nga: \_\_\_\_\_

Datë: 30.9.2013

Emri: Shkëlqim Cani

Pozicioni: Ministër i Financave



## SHTOJCA 1 PËRSHKRIMI I ZGJERUAR

### I. Hyrje

Kjo shtojcë përshkruan aktivitetet që duhet të ndërmerren dhe rezultatet që duhen arritur me fondet e dhëna sipas kësaj marrëveshjeje ndihme për objektivat e zhvillimit për forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjes së mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme. Asgjë në shtojcën 1 nuk interpretohet sikur amendon ndonjë prej përcaktimeve ose kushteve të marrëveshjes.

### II. Të dhëna paraprake

Strategjia e ndihmës së Shteteve të Bashkuara fokusohet në përparimin e përgjithshëm të Shqipërisë, duke mbështetur forcimin e institucioneve të saj demokratike, duke nxitur prosperitetin ekonomik dhe duke çuar përpara integrimin e saj të mëtejshëm në strukturat europiane dhe euroatlantike. Duke pasur parasysh kufizimet buxhetore dhe në kontekstin e planifikimit të vazhdueshmërisë, USAID /Shqipëri ka hartuar një strategji, e cila do të fokusohet në shfrytëzimin e ndikimit të SHBA-së në reforma në nivel politikash. Fokusi i programit për tri vitet e ardhshme do të jetë puna me qeverinë e Shqipërisë (GOA) dhe me sektorin privat për reforma shndërruese dhe ndryshime të orientuara drejt rezultateve në mjedisin rregullator që do të çojë drejt forcimit të institucioneve të fuqizuara demokratike dhe rritjes ekonomike të qëndrueshme. Kjo do ta pozicionojë më mirë Shqipërinë për të arritur aspiratat e veta të integritimit europian, duke qenë se strategjia e USAID-it është në një linjë me strategjinë aktuale kombëtare të qeverisë shqiptare për zhvillim dhe integrim. Për këtë qëllim, USAID/Shqipëri ka përgatitur një strategji bashkëpunimi për zhvillimin e vendit (CDCS) që cakton objektivat e ndihmës së SHBA-së në Shqipëri.

### III. Plani financiar

Plani financiar për të arritur objektivat dhe rezultatet përcaktohet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Fusha e programit	VF 2013	Totali VF 2013-VF 2016
1	Shteti ligjor dhe të drejtat e njeriut	\$ 2,189,000	\$5,339,000
2	Qeverisja e mirë	\$3,215,000	\$ 11,003,000
3	Shoqëria civile	\$0	\$1,000,000
4	Tregtia dhe investimet	\$500,000	\$1,500,000
5	Spektori financiar	\$1,250,000	\$1,950,000
6	Konkurrueshmëria e sektorit privat	\$1,817,000	\$4,817,000
7	Mbështetja për programin	\$935,291	\$2,935,000
	<b>TOTALI</b>	<b>\$9,906,291</b>	<b>\$28,544,000</b>

### IV. Objektivat e marrëveshjes dhe rezultatet për t'u arritur

Kjo marrëveshje mbështet shndërrimin e Shqipërisë në një demokraci funksionale, të qëndrueshme nga ana shoqërore dhe ekonomike. Marrëveshja do të përmbushet përmes zbatimit të aktiviteteve të përzgjedhura në dy objektivat e zhvillimit: OZH #1 Forcimi i shtetit të së drejtës dhe qeverisja e mirë; dhe OZH #2 Krijimi i kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Sinergjitë midis këtyre dy objektivave janë jashtëzakonisht të forta, në mënyrë që sukcesi në arritjen e një transparence më të madhe dhe në uljen e korrupsionit të ndikojë pozitivisht në sektorin privat, dhe nga ana tjetër, rritja ekonomike të ndihmojë për krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm për një demokraci të lirë dhe të hapur. Zbatimi në rritje i sistemeve elektronike, i aplikuar me sukses në programin e pragut të korporatës së sfidës së mijëvjeçarit, do të jetë një mjet kyç në të dy OZH-të për promovimin e transparencës dhe uljen e korrupsionit.

#### OZH #1 Forcimi i shtetit të së drejtës dhe qeverisja e mirë

Qëllimi. Ky OZH trajton drejtpërdrejt një aspekt kryesor të qëllimit të ndihmës së qeverisë së SHBA-së në Shqipëri, që është forcimi i institucioneve demokratike. Duke pasur parasysh se Shqipëria ka ardhur nga një periudhë komunizmi të egër, në njëzet vitet e fundit është arritur progres relativisht i mirë drejt një shoqërie të lirë dhe demokratike. Megjithatë, mbetet shumë për të bërë nëse Shqipëria

duhet të realizojë integrimin europian në shkallë më të gjerë. Trajtimi i elementeve kyç të këtij OZH - përmirësime në gjyqësor dhe në menaxhimin e kujdesit shëndetësor, thellimi i procesit të decentralizimit, dhe çrrënjësja e korrupsionit - do ta çojë Shqipërinë më shpejt përpara drejt një demokracie më të madhe, duke përbushur ndërkohë kriteret që janë thelbësore për arritjen e aspiratave të saj europiane.

Ky OZH është përzgjedhur për forcimin e mëtejshëm të institucioneve demokratike në vend dhe për të trajtuar korrupsionin, i cili dëmton zhvillimin ekonomik dhe besimin e qytetarëve, dhe bie ndesh në nivel të konsiderueshëm me standardet e BE-së për transparencën, përgjegjshmërinë dhe decentralizimin e autoriteteve. Si ndërhyrje, do të përzgjidhen ato që forcojnë institucionet kyçe, promovojnë shoqërinë civile dhe ulin korrupsionin, me rezultate që do të shihen nga demokracia dhe qeverisja deri në sektorin privat. Nën këtë OZH do të ketë një fokus të fuqishëm në forcimin e marrëdhënieve midis qeverisë qendrore dhe vendore, me qëllim përmirësimin e planifikimit, krijimin e kuadrit për zhvillimin e një plani kombëtar territorial, dhe sigurimin e ofrimit më eficient dhe transparent të shërbimeve publike kryesore që prekin jetën e përditshme të të gjithë qytetarëve, si p.sh.: ujë, kanalizime, energji dhe arsim. Fokusi do të drejtohet fuqishëm në përmirësimin e mjedisit mundësues për reformën e politikave dhe planifikimin, në rritjen e mbikëqyrjes qytetare dhe transparencës, dhe në përmirësimin e aftësive të kryerjes së punës dhe menaxhimit në fushën e gjyqësorit dhe në atë të ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Rezultatet e pritshme: Aktivitetet e përfshira nën këtë marrëveshje që mbështet këtë objektiv do të fokusohen në rezultatet e mëposhtme:

- Përmirësim i mjedisit mundësues për reformën e politikave dhe planifikimit në qeverisjen vendore, drejtësi dhe shëndetësi;
- Rritje e mbikëqyrjes qytetare dhe transparencës në qeverisjen vendore, drejtësi dhe shëndetësi;
- Përmirësim i aftësive të kryerjes së punës dhe menaxhimit në qeverisjen vendore, drejtësi dhe shëndetësi.

OZH #2 Krijimi i kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse

Qëllimi. Duke theksuar përparësitë e veta strategjike, qeveria shqiptare aspirojnë për një normë të vazhdueshme të rritjes ekonomike, të ngjashme me 6-përqindëshin historik, çka do të jetë sfiduese të arrihet duke pasur parasysh mjedisin aktual financiar dhe atë të biznesit, si dhe efektin e krizës së Eurozonës. Duke siguruar asistencë teknike, me objektiva të mirëpërcaktuar në nivel politikash, ky OZH do të ndihmojë për krijimin e një kuadri brenda të cilit mund të arrihet kjo aspiratë, mund të realizohet stabiliteti makroekonomik, mund të rritet integrimi rajonal, dhe mund të arrihet një standard jetese më shumë i krahasueshëm me atë të Europës së madhe.

Ky OZH do të fokusohet në realizimin e atyre reformave dhe rregulloreve që do të çojnë drejt një mjedisi më të mirë për biznesin, drejt mikrondërmarrjeve, ndërarrjeve të vogla dhe të mesme (MSME) më konkurruese dhe drejt një sektori financiar më të fuqishëm. Përmirësimi i dialogut midis qeverisë shqiptare dhe sektorit privat do të inkurajohet duke punuar me dhoma dhe shoqata, në mënyrë që të identifikohen dhe të hiqen kufizimet ndaj biznesit. Përdorimi efektiv i partneriteteve publike-private (PPP) do të ndihmojë të mbushë një boshllëk serioz të burimeve në vend gjatë trajtimit të çështjeve të infrastrukturës (energji, rrugë, porte etj.) dhe të kufizimeve të tjera, si p.sh., marketingun agrar. Asistenca teknike e mirëmenduar për sektorin financiar do të forcojë më tej autoritetet rregullatore.

Rezultatet e pritshme: Aktivitetet e përfshira nën këtë marrëveshje, që mbështesin këtë objektiv, do të fokusohen në rezultatet e mëposhtme:

- Rritje e mundësive për sektor privat për shqiptarët dhe për të kthyerit nga vendet e Eurozonës;
- Përmirësim i kushteve për zhvillimin e sektorit të administruar nga privatët;
- Forcimi i konkurrueshmërisë në sektorin privat.

#### V. Indikatorët

Një listë e indikatorëve ilustrues për çdo objektiv është paraqitur si më poshtë:

#### OZH #1 Indikatorët ilustrues të performancës

- Perceptimet e publikut ndaj: a) qeverive vendore; b) menaxhimit të ofrimit të kujdesit shëndetësor; dhe c) performancës dhe ofrimit të shërbimit në sistemin gjyqësor (sondazhe të matura).



Indikatorët do të maten kundrejt të dhënave në zonat që nuk mbështeten nga qeveria e SHBA-së dhe në nivel kombëtar, sipas rasteve të zbatueshme.

- Perceptimet e publikut ndaj uljes së korrupsionit.
- Përqindja e njësive të qeverisjes vendore me mekanizma të ndërtuar të transparencës dhe të përgjegjshmërisë ndaj qytetarëve.

- Përqindja e gjykatave me mekanizma të ndërtuar të transparencës dhe përgjegjshmërisë.
- Numri i personelit në sektorin e drejtësisë që marrin trajnime, asistencë, këshillime nëpërmjet mbështetjes së qeverisë të SHBA-së.

OZH #2 Indikatorët ilustrues të performancës

- Ndryshimi në përqindje në vlerën e eksporteve, si rrjedhojë, e mbështetjes së qeverisë të SHBA-së;

- Numri i sipërmarrësve që marrin trajnime, asistencë teknike dhe këshillime nga shoqatat, me mbështetje nga qeveria e SHBA-së;

- Numri i shoqatave të biznesit dhe i dhomave që bëhen më përfshirëse në strukturën e tyre të anëtarësimit dhe menaxhimit;

- Politikat, strategjitë, rregulloret e reja apo reformat e qeverisë që trajtojnë promovimin e investimeve, duke pranuar dhe duke iu përgjigjur sfidave me të cilat ndeshen në veçanti, zhvillimi i grave dhe kompanitë në pronësi të minoriteteve.

VI. Përzgjedhja e aktivitetit/aktiviteteve

Theksi në këtë marrëveshje do të jetë arritja e rezultateve të lartpërmendura. Për rrjedhojë, aktivitetet që do të financohen nën këtë marrëveshje janë përzgjedhur për të arritur këtë qëllim. Në vijim, paraqitet një listë e aktiviteteve aktuale që do të financohen sipas kësaj marrëveshjeje:

- Mbështetje e reformës së drejtë në shëndetësi;
- Telemjekësia dhe shëndetësia elektronike e integruar në Shqipëri;
- Projekti i forcimit të sektorit të drejtësisë shqiptare;
- Programi i zhvillimit të sektorit financiar;
- Programi i planifikimit dhe i qeverisjes vendore;
- Programi i ndërtimit të kapaciteteve njerëzore dhe institucionale.

USAID-i do të shqyrtojë mundësinë e kryerjes së aktiviteteve të reja për t'u financuar nën këtë marrëveshje: 1) që kontribuojnë në objektivat dhe rezultatet për programin e përmendur më lart; 2) që mbështeten me analiza dhe planifikim të përshtatshëm; dhe 3) që pritet të përfundojnë brenda afatit kohor dhe buxhetit të specifikuar.

VII. Rolet dhe përgjegjësitë

A. Përfituesi i ndihmës

Në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të kësaj marrëveshjeje, Përfituesi i Ndihmës do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të siguruar arritjen e objektivave dhe të rezultateve, siç parashikohen në këtë marrëveshje. Ndihma e parashikuar në këtë marrëveshje do të kërkojë që Departamenti i Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (DSKNH) të kryejë koordinimin ndërmjet ministrive përkatëse, sipas nevojës.

B. USAID-i

USAID-i do të koordinojë dhe do të komunikojë me Përfituesin e Ndihmës për të arritur me sukses objektivat dhe rezultatet e parashikuara në këtë marrëveshje.

Përveç marrëveshjeve me qeverinë e Shqipërisë, USAID-i do të hyjë në një ose më shumë marrëveshje me një ose më shumë partnerë zbatues (partnerë zbatues) palë të treta për të zbatuar aktivitetet sipas kësaj marrëveshjeje. Marrëveshje të tilla mund të përfshijnë ndihma, marrëveshje bashkëpunimi dhe kontrata. Partnerët zbatues mund të jenë organizata ose individë lokalë nga Shtetet e Bashkuara, organizata ndërkombëtare ose shumëkombëshe, qeveritare ose joqeveritare.

USAID-i do të monitorojë performancën, sipas këtyre marrëveshjeve, dhe do të monitorojë performancën e partnerëve zbatues dhe ecurinë drejt arritjes së rezultateve.

USAID-i do t'i japë Përfituesit të Ndihmës informacion mbi disbursimet që lidhen me këtë marrëveshje, në një formë dhe përmbajtje, siç është rënë dakord ndërmjet dy palëve.

### C. Partnerët zbatues

USAID-i do të përzgjedhë partnerët zbatues në përputhje me rregulloret dhe politikat e USAID-it. USAID-i do të sigurojë që partnerët zbatues të kryejnë zbatimin e aktiviteteve në përputhje me këtë marrëveshje dhe t'i raportojnë drejtpërdrejt USAID-it.

### VIII. Monitorimi dhe vlerësimi

USAID-i do të identifikojë etapat dhe synimet për matjen e performancës së aktiviteteve që do të zbatohen nën këtë marrëveshje. Ecuria drejt etapave dhe synimeve do të vlerësohet mbi bazë vjetore, në konsultim me Përfituesin e Ndihmës. Qëllimi i këtyre synimeve është vlerësimi i shpejtësisë për arritjen e objektivave dhe rezultateve, dhe informimi i palëve në lidhje me vazhdimin, rritjen apo përshtatjen e aktiviteteve.

## SHTOJCA 2 DISPOZITAT STANDARDE

### Përmbajtja

Neni A: Përkufizimet dhe dokumentet e zbatimit

Seksioni A.1. Përkufizimet

Seksioni A.2. Dokumentet e zbatimit

Neni B: Kërkesa të përgjithshme

Seksioni B.1. Konsulenca

Seksioni B.2. Zbatimi i marrëveshjes

Seksioni B.3. Përdorimi i mallrave dhe i shërbimeve

Seksioni B.4. Taksimi

Seksioni B.5. Raportet dhe informacioni, regjistrat dhe të dhënat, auditimet dhe inspektimet

Seksioni B.6. Plotësia e informacionit

Seksioni B.7. Pagesa të tjera

Seksioni B.8. Informacioni dhe identifikimi

Neni C: Dispozitat e prokurimit

Seksioni C.1. Origjina dhe kombësia

Seksioni C.2. Data e vlefshmërisë

Seksioni C.3. Planet, specifikimet dhe kontratat

Seksioni C.4. Çmimi i arsyeshëm

Seksioni C.5. Njoftimi i furnitorëve potencialë

Seksioni C.6. Transportimi

Seksioni C.7. Sigurimi

Seksioni C.8. Pasuria që tepron në pronësi të qeverisë së Shteteve të Bashkuara

Neni D: Disbursimet

Seksioni D.1. Disbursimet

Seksioni D.2. Kursi i këmbimit

Neni E: Zgjidhja; dëmshpërblimet

Seksioni E.1. Pezullimi dhe zgjidhja

Seksioni E.2. Rfinansimi

Seksioni E.3. Dëmshpërblimet e detyrueshme

Seksioni E.4. Transferimi

Neni F: Të ndryshme

Seksioni F.1. Promovimi i investimit

Seksioni F.2. Planifikimi familjar vullnetar

Seksioni F.3. Të drejtat e punëtorëve

Seksioni F.4. Financimi i terrorizmit



## DISPOZITA STANDARDE

### Neni A

#### **Përkufizime dhe dokumente zbatimi**

Seksioni A.1. Përkufizime. E përdorur në këtë shtojcë, “marrëveshja” i referohet marrëveshjes së asistencës së cilës i bashkëlidhet kjo shtojcë dhe pjesë të së cilës përbën kjo shtojcë. Termat e përdorur në këtë shtojcë kanë të njëjtin kuptim ose referencë si marrëveshja.

Seksioni A.2. Dokumentet e zbatimit. Për të ndihmuar Përfituesin e Ndihmës në zbatimin e marrëveshjes, USAID-i herë pas here lëshon dokumente zbatimi që japin informacion shtesë në lidhje me çështjet e përcaktuara në këtë marrëveshje. Palët mund të lëshojnë, gjithashtu, dokumente zbatimi të miratuara bashkërisht për të konfirmuar dhe regjistruar mirëkuptimin e tyre reciprok për aspekte të zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Dokumentet e zbatimit mund të lëshohen, gjithashtu, për të regjistruar rishikimet ose përjashtimet që lejohen nga kjo marrëveshje.

### Neni B

#### **Kërkesa të përgjithshme**

Seksioni B.1. Konsulenca. Palët bashkëpunojnë për të garantuar arritjen e objektivave dhe rezultateve të kësaj marrëveshjeje. Për këtë qëllim, palët, me kërkesë të secilës, shkëmbejnë mendime mbi përparimin drejt objektivave dhe rezultateve, përbushjen e detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje, punën e çdo konsulenti, kontraktori ose furnitori të përfshirë sipas marrëveshjes dhe çështje të tjera në lidhje me këtë marrëveshje.

Seksioni B.2. Ekzekutimi i marrëveshjes. Përfituesi i Ndihmës:

a) Përbush marrëveshjen dhe aktivitetet që kërkohen të ndërmerren drejtpërdrejt (ose për të cilat duhet të merren masa) nga Përfituesi i Ndihmës, ose të marrin masa për përbushjen e kësaj marrëveshjeje dhe aktiviteve me kujdesin dhe efikasitetin e duhur, në pajtim me praktikën e qëndrueshme teknike, financiare dhe menaxheriale dhe në pajtim me dokumentet, planet, specifikimet, kontratat, programet ose masat e tjera dhe me modifikimet e tyre, të aprovuara nga USAID-i, në pajtim me këtë marrëveshje; dhe

b) Ofron personel menaxhues të kualifikuar dhe me përvojë dhe e trajnon personelin rregullisht për mbajtjen dhe zhvillimin e aktiviteve të financuara sipas kësaj marrëveshjeje dhe sipas rastit, për aktivitetet në vazhdim, merr masa që këto aktivitete të operohen dhe mbahen në mënyrë të tillë që të garantohet arritja e vazhdueshme dhe e suksesshme e objektivave dhe e rezultateve sipas marrëveshjes.

Seksioni B.3. Përdorimi i mallrave dhe i shërbimeve. Çdo mall ose shërbim i financuar sipas kësaj marrëveshjeje, përveç kur është rënë dakord ndryshe me shkrim nga USAID-i, i dedikohet marrëveshjes deri në përfundimin ose prishjen e kësaj të fundit, dhe pas kësaj (si dhe gjatë çdo periudhe pezullimi të marrëveshjes) do të përdoret për arritjen e objektivit dhe rezultateve të marrëveshjes ose siç mund të udhëzojë USAID-i në dokumentet e zbatimit.

Seksioni B.4. Taksimi

a) Përjashtim i përgjithshëm. Marrëveshja dhe asistenca sipas saj përjashtohen nga çdo tatim i caktuar sipas ligjeve në fuqi në territorin e Përfituesit të Ndihmës.

b) Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë dispozitë, përjashtimi i përgjithshëm i nënseksionit (a) zbatohet, pa u kufizuar, në: 1) çdo aktivitet, kontratë, ndihmë ose marrëveshje tjetër zbatuese të financuar nga USAID-i sipas kësaj marrëveshjeje; 2) çdo veprim ose furnizim, pajisje, materiale, pronë ose mallra të tjera (këtu të quajtura bashkërisht “mallra”) sipas pikës 1 më sipër; 3) çdo kontraktor, përfitues ndihme ose organizatë tjetër që kryen aktivitetet e financuara nga USAID-i sipas kësaj marrëveshjeje; 4) çdo punonjës i këtyre organizatave; dhe 5) çdo kontraktor individual ose përfitues ndihme, i cili kryen aktivitetet e financuara nga USAID-i sipas kësaj marrëveshjeje.

c) Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë dispozitë, përjashtimi i përgjithshëm në nënseksionin (a) zbatohet, por pa u kufizuar për tatimet e mëposhtme:

1. Përjashtimi 1. Detyrimet doganore, tarifatat, tatimi mbi importin ose detyrime të tjera mbi importimin, përdorimin dhe rieksporimin e mallrave ose sendeve personale (duke përfshirë automjetet në

pronësi private) për përdorimin personal të individëve jovendas ose të anëtarëve të familjeve të tyre.

Përfshirja 1 përfshin, pa u kufizuar, të gjitha detyrimet e bazuara në vlerën e këtyre mallrave të importuara, por nuk përfshin detyrimet e shërbimit drejtpërdrejt të lidhura me shërbimet e kryera për transferimin e mallrave ose ngarkesave.

2. Përfshirja 2. Tatimin mbi të ardhurat, fitimet ose pronën e të gjithë: i) organizatave jovendase të çdo lloji; ii) punonjësit jovendas të organizatave vendase ose jovendase; ose iii) kontraktorët ose përfituesit e ndihmës, individualë jovendas. Përfshirja 2 përfshin të ardhurat dhe taksat për sigurimet shoqërore të të gjithë tipave dhe të gjitha taksat mbi pasurinë, personale ose të patundshme, në pronësi të këtyre organizatave ose personave jovendas. Termi “vendas” u referohet organizatave të themeluara sipas ligjeve të Përfituesit të Ndihmës dhe shtetasve të Përfituesit të Ndihmës, të ndryshëm nga shtetasit e huaj me qëndrim të përhershëm në Shtetet e Bashkuara.

3. Përfshirja 3. Tatimet e vendosura për veprimin e fundit për blerjen e mallrave ose shërbimeve të financuara nga USAID-i sipas kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë taksat e shitjes, taksat mbi vlerën e shtuar (TVSH) ose tatimet për blerjen ose rentën e pasurisë së patundshme ose personale. Termi “veprim i fundit” i referohet veprimit të fundit nëpërmjet të cilit blihen mallrat ose shërbimet për përdorim në aktivitetet e financuara nga USAID-i sipas kësaj marrëveshjeje.

d) Nëse një taksë është vendosur dhe paguar në kundërshtim me dispozitat e një përfshirjeje, USAID-i, sipas diskrecionit të tij, mund t'i: 1) kërkojë Përfituesit të Ndihmës të kompensojë USAID-in ose të tjerë sipas udhëzimit të USAID-it me shumën e këtyre taksave me fonde të ndryshme nga ato të dhëna sipas marrëveshjes; ose 2) kompensojë shumën e kësaj takse me shumat që duhet të disbursohen sipas kësaj ose një marrëveshjeje tjetër ndërmjet palëve.

e) Në rastin e një mosmarrëveshjeje në lidhje me zbatimin e një përfshirjeje, palët bien dakord të takohen menjëherë dhe të zgjidhin këto çështje, të udhëhequra nga parimi që asistencë nga USAID-i përjashtohet nga tatimi i drejtpërdrejtë, kështu që e gjithë asistencë e dhënë nga USAID-i do të kontribuojë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit të Përfituesit të Ndihmës.

Seksioni B.5. Raportet dhe informacioni, regjistrat dhe të dhënat, auditimet dhe inspektimet sipas marrëveshjes

a) Raportet dhe informacioni. Përfituesi i jep USAID-it të dhënat e kontabilitetit dhe informacion dhe raporte të tjera në lidhje me marrëveshjen që USAID-i mund t'i kërkojë.

b) Regjistrat dhe të dhënat e marrëveshjes së ndihmës. Përfituesi i Ndihmës do të mbajë librat e llogarisë, të dhënat, dokumentet dhe dëshmitë e tjera në lidhje me marrëveshjen, të mjaftueshme për të përcaktuar, pa kufizim, të gjitha kostot e shkaktuara direkt nga Përfituesi i Ndihmës sipas marrëveshjes, marrjen dhe përdorimin e mallrave dhe shërbimeve të blera nga Përfituesi i Ndihmës sipas marrëveshjes, kërkesat e ndarjes së kostos për të cilat është rënë dakord, natyrën dhe shkallën e kërkesave të furnitorëve potencialë të mallrave dhe shërbimeve të përftuara nga Përfituesi i Ndihmës, bazën e dhënies së kontratave dhe urdhrave të kryer direkt nga Përfituesi i Ndihmës, si dhe përparimin e përgjithshëm të marrëveshjes drejt përfundimit (regjistrat dhe të dhënat e marrëveshjes). Përfituesi i Ndihmës do të mbajë regjistrat dhe të dhënat e marrëveshjes në përputhje me parimet e kontabilitetit, të pranuar përgjithësisht që mbizotërojnë në Shtetet e Bashkuara, ose në opsionin e Përfituesit të Ndihmës, me miratim nga USAID-i, me parime të tjera të kontabilitetit, të tilla si ato: 1) të përshkruara nga Komiteti Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (një filial i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve); ose 2) që mbizotërojnë në shtetin e Përfituesit të Ndihmës. Regjistrat dhe të dhënat e marrëveshjes do të mbahen për të paktën tre vjet pas datës së disbursimit të fundit nga USAID-i ose për periudhë më të gjatë, nëse ka, të nevojshme për të zgjidhur ndonjë çështje gjyqësore, pretendimet ose rezultatet e auditimit. Për shmangien e dyshimit, ky seksion B.5 (b) zbatohet vetëm për fondet e ndihmës, të shpenzuara drejtpërdrejt nga Përfituesi i Ndihmës.

c) Auditimi i ndihmës. Nëse 300.000 \$ ose më shumë prej fondeve të USAID-it janë shpenzuar drejtpërdrejt nga Përfituesi i Ndihmës në vitin e tij fiskal sipas marrëveshjes, Përfituesi i Ndihmës do të sigurojë auditime financiare të shpenzimeve në përputhje me kushtet e mëposhtme, përveç rasteve kur palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim:





1. Me miratimin e USAID-it, Përfituesi i Ndihmës do të përdorë institucionin e vet suprem të auditimit ose do të zgjedhë një auditues të pavarur në përputhje me “Udhëzimet për kontrollet financiare të kontraktuara nga përfituesit e huaj”, të lëshuara nga inspektori i përgjithshëm i USAID-it (udhëzimet), dhe auditimet do të kryhen në përputhje me “udhëzimet”; dhe

2. Auditimi do të përcaktojë nëse marrja dhe shpenzimi i fondeve të siguruara sipas marrëveshjes, paraqiten në përputhje me parimet e kontabilitetit të pranuar përgjithësisht, siç bihet dakord në paragrafin (b) më sipër dhe nëse Përfituesi i Ndihmës është në pajtim me kushtet e marrëveshjes. Çdo kontroll financiar do të përfundojë jo më vonë se nëntë muaj pas mbylljes së vitit, që është nën auditim, të Përfituesit të Ndihmës.

d) Auditimet e nënpërfituesit. Përfituesi i Ndihmës, përveç kur palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim, do t'i dorëzojë USAID-it, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për USAID-in, një plan për auditimin e shpenzimeve të nënpërfituesve të “mbuluar”, të përcaktuara si më poshtë, që marrin fonde në lidhje me një kontratë të drejtpërdrejtë ose në marrëveshje të bërë drejtpërdrejt me Përfituesin e Ndihmës në përputhje me aktivitetet e parashikuara nga kjo marrëveshje.

1. Një nënpërfitues “i mbuluar” është ai që shpenzon 300.000 \$ ose më shumë në vitin e tij fiskal në kontratat e “USAID-it” (d.m.th., si nënpërfitues sipas objektivit strategjik të USAID-it dhe marrëveshjeve të tjera të ndihmës me qeveritë e huaja).

2. Plani do të përshkruajë metodologjinë që do të përdoret nga ana e Përfituesit të Ndihmës për të përmbushur përgjegjësitë e veta të auditimit për nënpërfituesit “e mbuluar”. Përfituesi i Ndihmës mund të përmbushë përgjegjësi të tilla të auditimit duke u mbështetur në kontrollet e pavarura të nënpërfituesve; duke zgjeruar fushëveprimin e auditimit të pavarur financiar të Përfituesit të Ndihmës për të përfshirë testimin e llogarive të nënpërfituesve ose një kombinim të këtyre procedurave.

3. Plani do të identifikojë fondet e vëna në dispozicion për nënpërfituesit “e mbuluar” që do të mbulohen nga auditimet e kryera në përputhje me dispozitat e tjera të auditimit, të cilat do të përmbushnin përgjegjësitë e auditimit të Përfituesit të Ndihmës. (Një organizatë jofitimprurëse e organizuar në Shtetet e Bashkuara duhet të marrë masa për kontrollet e veta financiare. Një kontraktor fitimprurës i organizuar në Shtetet e Bashkuara, që ka një kontratë të drejtpërdrejtë me USAID-in, auditohet nga agjencia e njohur e qeverisë së SHBA-së. Një organizatë private vullnetare e organizuar jashtë Shteteve të Bashkuara me një ndihmë të drejtpërdrejtë nga USAID-i duhet të marrë masa për kontrollet e veta financiare. Një kontraktor nga vendi pritës duhet të auditohet nga agjencia e auditimit të Përfituesit të Ndihmës.)

4. Përfituesi i Ndihmës do të sigurojë që nënpërfituesit “e mbuluar” sipas kontratave ose marrëveshjeve të drejtpërdrejta me Përfituesin e Ndihmës, të ndërmarrin veprime korrigjuese, të duhura dhe në kohë; të shqyrtojnë nëse auditimet e nënpërfituesve kërkojnë rregullime të regjistrave të tyre; dhe që çdo nënpërfitues i tillë të lejojë auditë të pavarur të kenë qasje në të dhënat dhe pasqyrat financiare sipas nevojës.

e) Raportet e auditimit. Përfituesi i Ndihmës do t'i japë ose do të marrë masa që USAID-it t'i jepet një raport auditimi për çdo auditim të organizuar nga Përfituesi i Ndihmës në përputhje me këtë seksion brenda 30 ditëve, pas përfundimit të auditimit dhe jo më vonë se nëntë muaj pas përfundimit të periudhës së auditimit.

f) Nënpërfituesit e tjerë të mbuluar. Për nënpërfituesit “e mbuluar”, të cilët marrin fonde sipas marrëveshjes në pajtim me kontratat ose marrëveshjet e drejtpërdrejta me USAID-in, USAID-i përfshin kërkesa përkatëse auditimi në këto kontrata ose marrëveshje dhe, në emër të Përfituesit të Ndihmës, zhvillon aktivitete verifikuese në lidhje me raportet e auditimit të dhëna në pajtim me këto kërkesa.

g) Kostoja e auditimeve. Në bazë të aprovimit me shkrim të USAID-it, kostot e auditimeve të kryera në pajtim me kushtet e këtij seksioni mund t'i ngarkohen marrëveshjes.

h) Kontrolli financiar nga USAID-i. USAID-i ruan të drejtën për të kryer auditime që kërkohen sipas kësaj marrëveshjeje në emër të Përfituesit të Ndihmës duke shfrytëzuar fondet sipas marrëveshjes ose nga burime të tjera në dispozicion të USAID-it për këtë qëllim, për të kryer një rishikim financiar ose për të siguruar ndryshe përgjegjshmërinë e organizatave që shpenzojnë fondet e USAID-it, pavarësisht nga kërkesat e auditimit.

i) Mundësia për kontroll financiar ose inspektim. Përfituesi i Ndihmës do t'u japë mundësinë përfaqësuesve të autorizuar të USAID-it që në çdo kohë të arsyeshme të auditojnë ose të inspektojnë aktivitetet e financuara sipas marrëveshjes, shfrytëzimin e mallrave dhe shërbimeve të financuara nga USAID-i, dhe regjistrat, të dhënat dhe dokumentet e tjera që lidhen me marrëveshjen.

j) Regjistrat dhe të dhënat e nënpërfituesve. Përfituesi i Ndihmës do të përfshijë paragrafët (a), (b), (d), (e), (g), (h) dhe (i) të kësaj dispozite në të gjitha nënmarrëveshjet me organizata joamerikane, të cilat plotësojnë pragun 300.000 \$ të paragrafit (c) të kësaj dispozite. Nënmarrëveshjet me organizatat joamerikane, të cilat nuk plotësojnë pragun e 300.000 \$, duhet që minimalisht të përfshijnë paragrafët (h) dhe (i) të kësaj dispozite. Nënmarrëveshjet me organizatat amerikane do të deklarojnë se organizata amerikane u nënshtrohet kërkesave të auditimit të përfshira në OMB Qarkorja A-133.

Seksioni B.6. Plotësia e informacionit. Përfituesi i Ndihmës konfirmon:

a) Që faktet dhe rrethanat për të cilat ai ka informuar USAID-in ose që ka realizuar informimin e USAID-it në vazhden e arritjes së një marrëveshjeje me USAID-in për marrëveshjen, janë të sakta dhe të plota, dhe përfshijnë të gjitha faktet dhe rrethanat që mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme të marrëveshja dhe përmbushja e përgjegjësive sipas kësaj marrëveshjeje; dhe

b) Që ai do të informojë USAID-in në kohën e duhur për çdo fakt dhe rrethanë pasuese që mund të ndikojë në masë të konsiderueshme ose që mund të ekzistojë besimi se mund të ndikojë të marrëveshja ose përmbushja e përgjegjësive sipas kësaj marrëveshjeje.

Seksioni B.7. Pagesa të tjera. Përfituesi i Ndihmës konfirmon që asnjë pagesë nuk është marrë ose nuk do të merret nga asnjë punonjës i Përfituesit të Ndihmës në lidhje me prokurimin e mallrave ose shërbimeve të financuara sipas marrëveshjes, përveç tarifave, taksave ose pagesave të ngjashme të vendosura në mënyrë të ligjshme në vendin e Përfituesit të Ndihmës.

Seksioni B.8. Informacioni dhe identifikimi. Përfituesi i Ndihmës i bën marrëveshjes publicitet të përshtatshëm, si një program për të cilin kanë kontribuar Shtetet e Bashkuara, identifikon vendet e aktiviteteve të marrëveshjes dhe mallrat e financuara nga USAID-i, sipas përshkrimit në dokumentet e zbatimit.

## Neni C

### Dispozitat e prokurimit

Seksioni C.1. Origjina dhe kombësia

a) Disbursimet (pagesat) do të përdoren ekskluzivisht për të financuar kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për marrëveshjen në përputhje me marrëveshjen dhe që origjina dhe kombësia e të cilave është në vendet e përfshira në kodin gjeografik 937, përveç rasteve kur USAID-i mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim dhe si më poshtë:

1. Kostot e transportit transoqeanik do të financohen sipas marrëveshjes vetëm në anijet nën flamurin e regjistratit të vendeve të përfshira në kodin 935. Gjithashtu, shihni seksionin C.6 për përdorimin e anijeve me flamur amerikan.

2. Çdo automjet i financuar sipas marrëveshjes do të jetë prodhim i Shteteve të Bashkuara, me përjashtim kur USAID-i mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim.

b) Origjina e dërgimit me rrugë ujore ose ajrore konsiderohet të jetë vendi i anijes ose i avionit të regjistrimit në kohën e dërgimit.

c) Dispozitat në lidhje me mallrat dhe shërbimet e kufizuara dhe të papërshtatshme mund të gjenden në një dokument zbatimi.

d) Transportimi me rrugë ajrore i pronës ose personave të financuar nga kjo marrëveshje kryhet me transportuesit që kanë certifikimin e Shteteve të Bashkuara, në masën që shërbimet nga këta transportues janë të disponueshme sipas ligjit amerikan për fluturimin. Kjo kërkesë mund të përshkruhet më tej nga USAID-i në dokumentet e zbatimit.

Seksioni C.2. Data e pranueshmërisë. Asnjë mall ose shërbim nuk mund të financohet sipas kësaj marrëveshjeje nëse është prokuruar në pajtim me porositë ose kontratat e bëra ose të lidhura para datës së kësaj marrëveshjeje, përveç kur palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim.



Seksioni C.3. Planet, specifikimet dhe kontratat. Në mënyrë që të ketë marrëveshje të ndërsjellë për çështjet e mëposhtme, dhe përveç kur palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim:

a) Përfituesi i Ndihmës do t'i japë USAID-it, pas përgatitjes:

1. Plane, specifikime, afate prokurimi ose ndërtimi, kontrata, ose dokumentacion tjetër ndërmjet Përfituesit të Ndihmës dhe palëve të treta, në lidhje me mallrat ose shërbimet që do të financohen sipas marrëveshjes, duke përfshirë dokumentacionin në lidhje me parakualifikimin dhe përzgjedhjen e kontraktorëve dhe me kërkesat e ofertave dhe propozimeve. Gjithashtu, modifikimet materiale në këtë lloj dokumentacioni do t'i jepen USAID-it sapo të përgatiten; dhe

2. Një dokumentacion i tillë do t'i jepet USAID-it pas përgatitjes, në lidhje me mallra ose shërbime, të cilat, edhe pse jo të financuara sipas marrëveshjes, konsiderohen nga USAID-i të një rëndësie të veçantë për marrëveshjen. Aspektet e marrëveshjes që përfshijnë çështje sipas këtij nënseksioni (a) (2) do të identifikohen në dokumentet e zbatimit.

b) Dokumentet që lidhen me parakualifikimin e kontraktorëve, si dhe me kërkesën e ofertave ose propozimeve për mallra dhe shërbime të financuara sipas marrëveshjes, do të miratohen nga USAID-i me shkrim para lëshimit të tyre, dhe kushtet e tyre do të përfshijnë standardet dhe matjet e Shteteve të Bashkuara;

c) Kontratat dhe kontraktorët e financuar sipas marrëveshjes për shërbime inxhinierike dhe të tjera profesionale, për shërbime ndërtimi dhe për shërbime të tjera të tilla për pajisje apo materiale që mund të specifikohen në dokumentet e zbatimit, do të miratohen nga USAID-i me shkrim para ekzekutimit të kontratës. Modifikimet materiale në kontrata të tilla do të miratohen me shkrim nga USAID-i para ekzekutimit; dhe

d) Shoqëritë e konsulencës të përdorura nga Përfituesi i Ndihmës për marrëveshjen, por jo të financuara sipas marrëveshjes, fushëveprimin e shërbimeve dhe atë të personelit të tyre, të caktuar për aktivitetet e financuara sipas marrëveshjes, ashtu siç USAID-i mund t'i specifikojë, dhe kontraktorët e ndërtimit të përdorur nga Përfituesi i Ndihmës për marrëveshjen por jo të financuara sipas marrëveshjes, do të jenë të pranueshme për USAID-in.

Seksioni C.4. Çmimi i arsyeshëm. Nuk tejkalohej çmimi i arsyeshëm për asnjë nga mallrat ose shërbimet e financuara, plotësisht ose pjesërisht, sipas kësaj marrëveshjeje. Këta artikuj prokurohen mbi një bazë të drejtë dhe në masën më të gjerë të mundshme, konkurruese.

Seksioni C.5. Njoftimi i furnitorëve potencialë. Për t'u mundësuar të gjitha firmave të Shteteve të Bashkuara pjesëmarrjen në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve që financohen sipas marrëveshjes, Përfituesi i Ndihmësi jep USAID-it për këtë qëllim atë informacion dhe në atë kohë që USAID-i mund ta kërkojë në dokumentet e zbatimit.

Seksioni C.6. Transporti

a) Përveç kërkesave të seksionit C.1 (a), kostoja e transportit ujor ose ajror dhe shërbimet përkatëse të dorëzimit nuk mund të financohen sipas marrëveshjes, nëse shpenzimet janë për transportin sipas një kontrate transporti ujor ose ajror për të cilin nuk është marrë aprovimi i USAID-it.

b) Përveç kur USAID-i përcakton që anijet ujore tregtare me flamur të Shteteve të Bashkuara nuk janë të disponueshme me tarifa të drejta dhe të arsyeshme për këto anije ose kur bie dakord me shkrim:

1. Të paktën pesëdhjetë për qind (50%) e tonazhit bruto të të gjithë mallrave (të llogaritur veçmas për transportuesit për mall rifuxho, linjat e artikujve të ngurtë dhe cisternat) të financuara nga USAID-i, që mund të transportohen në anije, do të transportohen në anijet në pronësi private me flamur të Shteteve të Bashkuara; dhe

2. Të paktën pesëdhjetë për qind (50%) e të ardhurave bruto nga ngarkesat të gjeneruara nga të gjitha dërgesat e financuara nga USAID-i dhe që transportohen në territorin e Përfituesit të Ndihmës me linja për artikuj të ngurtë u paguhen anijeve tregtare në pronësi private që kanë flamurin e Shteteve të Bashkuara ose në interes të tyre. Pajtueshmëria me kërkesat 1 dhe 2 të këtij nënseksioni duhet të arrihet në lidhje me mallrat e transportuara nga portet e SHBA-së edhe për mallrat e transportuara nga portet jo të SHBA-së, të llogaritura veçmas.

Seksioni C.7. Siguracioni

a) Sigurimi detar për mallrat e financuara nga USAID-i, të cilat duhet të transportohen në territorin e Përfituesit të Ndihmës mund të financohet si kosto e shkëmbimit të huaj sipas kësaj marrëveshjeje, me kusht që:

1. Ky sigurim të jepet si norma më e leverdishme konkurruese;
2. Ky sigurim të jepet në një vend që është i autorizuar sipas seksionit C.1 (a); dhe
3. Pretendimet sipas tij janë të pagueshme në dollarë amerikanë ose në një monedhë lirisht të këmbyeshme, përveç kur USAID-i bie dakord ndryshe me shkrim.

Nëse Përfituesi i Ndihmës (ose qeveria e Përfituesit të Ndihmës) bën dallime me ligj, dekret, rregull, rregullore ose praktikë në lidhje me prokurimin e financiar nga USAID-i ndaj një shoqërie të sigurimit detar të autorizuar që të kryejë biznes në një shtet të Shteteve të Bashkuara, të gjitha mallrat e dërguara në territorin e Përfituesit të Ndihmës të financuara nga USAID-i sigurohen kundrejt risqeve detare dhe ky sigurim lidhet në Shtetet e Bashkuara me një ose disa shoqëri të autorizuar që të kryejnë biznes sigurimi detar në Shtetet e Bashkuara.

b) Përveç kur USAID-i bie dakord ndryshe me shkrim, Përfituesi i Ndihmës siguron ose merr masa për sigurimin e mallrave të financuara sipas marrëveshjes të importuara për marrëveshjen kundrejt risqeve para kalimit të tyre në pikën e përdorimit sipas marrëveshjes; ky sigurim lidhet në pajtim me termat dhe kushtet sipas praktikave të qëndrueshme tregtare dhe siguron vlerën e plotë të mallrave. Çdo zhdëmtim i marrë nga Përfituesi i Ndihmës sipas këtij sigurimi përdoret për të zëvendësuar ose riparuar çdo dëm material ose çdo humbje të mallrave të siguruar ose që përdoret për të riimbursuar Përfituesin e Ndihmës për zëvendësimin ose riparimin e këtyre mallrave. Çdo zëvendësim i tillë është me burim dhe origjinë në vendet e renditura në kodin gjeografik 935 të USAID-it, që është në fuqi në momentin e zëvendësimit dhe, përveç kur palët bien dakord me shkrim, u nënshtrohet dispozitave të marrëveshjes.

Seksioni C.8. Pasuria që tepron në pronësi të qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Përfituesi i Ndihmës bie dakord që nëse është e mundur duhet të përdoret pasuria personale që tepron në pronësi të qeverisë së Shteteve të Bashkuara, në vend të artikujve të tjerë të financiar sipas marrëveshjes. Fondet sipas marrëveshjes mund të përdoren për të financuar koston e përfitimit të kësaj pasurie.

## Neni D Disbursimet

Seksioni D.1. Disbursimet. Disbursimet do të bëhen me anë të mjeteve të tilla që palët mund të bien dakord me shkrim

Seksioni D.2. Kursi i këmbimit. Nëse fondet e dhëna sipas kësaj marrëveshjeje prezantohen në vendin bashkëpunues nga USAID-i ose një agjenci publike ose private për qëllimet e përmbushjes së detyrimeve të USAID-it, Përfituesi i Ndihmës merr ato masa që mund të jenë të nevojshme në mënyrë që këto fonde të mund të konvertohen në monedhën vendase me normën më të lartë të këmbimit që, në momentin e kryerjes së këmbimit, nuk është e paligjshme në vendin e Përfituesit të Ndihmës të ndonjë person për ndonjë qëllim të caktuar.

## Neni E Zgjidhja; mjetet ligjore

Seksioni E.1. Pezullimi dhe zgjidhja

a) Secila palë mund të zgjidhë këtë marrëveshje në tërësinë e saj duke i bërë palës tjetër një njoftim paraprak me shkrim tridhjetë (30) ditë para. USAID-i mund të zgjidhë këtë marrëveshje pjesërisht duke i bërë Përfituesit të Ndihmës një njoftim me shkrim tridhjetë (30) ditë para dhe të pezullojë këtë marrëveshje plotësisht ose pjesërisht, duke i bërë Përfituesit të Ndihmës një njoftim me shkrim. Përveç kësaj, USAID-i mund ta prishë këtë marrëveshje plotësisht ose pjesërisht, duke i bërë njoftim me shkrim Përfituesit të Ndihmës, nëse: i) Përfituesi i Ndihmës nuk përmbush ndonjë prej dispozitave të kësaj marrëveshjeje; ii) ndodh një ngjarje që USAID-i vendos se e bën të pamundur arritjen e objektivit ose rezultateve të marrëveshjes ose programit të asistencës ose që Përfituesi i Ndihmës do të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje; ose iii) çdo disbursim ose përdorim fondesh në mënyrën e parashikuar do të ishte shkelje e legjislacionit që rregullon USAID-in që është në fuqi në atë kohë ose më vonë.



b) Përveç pagesës që palët janë të detyruara të bëjnë në pajtim me detyrimet e paanulueshme të lidhura me palët e treta para pezullimit ose zgjidhjes, pezullimi ose zgjidhja e tërë kësaj marrëveshjeje ose pjesë të saj pezullon (për periudhën e pezullimit) ose pushon, sipas rastit, çdo detyrim të palëve për dhënien e burimeve financiare ose të tjera të marrëveshjes ose për pjesën e pezulluar, ose të pushuar të marrëveshjes, sipas rastit. Çdo pjesë e kësaj marrëveshjeje që nuk pezullohet ose pushohet, mbetet në fuqi të plotë.

c) Përveç kësaj, pas pezullimit ose zgjidhjes së plotë ose të pjesshme, USAID-i, me shpenzimet e tij, mund të udhëzojë që titulli për mallrat e financuara sipas marrëveshjes ose sipas pjesës së zbatueshme të marrëveshjes, t'i transferohet USAID-it nëse mallrat janë në një gjendje që mund të dorëzohen.

#### Seksioni E.2. Shlyerjet

a) Në rast të ndonjë disbursimi, i cili nuk është mbështetur me dokumentacion të vlefshëm në përputhje me këtë marrëveshje, ose që nuk është bërë apo përdorur në përputhje me këtë marrëveshje, ose është për mallrat ose shërbimet që nuk janë përdorur në përputhje me këtë marrëveshje, USAID-i, pavarësisht nga disponueshmëria ose ushtrimi i ndonjë mjeti tjetër sipas kësaj marrëveshjeje, mund t'i kërkojë marrësit të ndihmës të rimbursojë shumën e disbursimit në dollarë amerikanë ndaj USAID-it brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas marrjes së kërkesës për to.

b) Nëse marrësi i ndihmës nuk përmbush një nga detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje dhe rezulton që mallrat ose shërbimet e financuara ose të mbështetura sipas marrëveshjes, nuk janë përdorur në mënyrë efektive në përputhje me këtë marrëveshje, USAID-i mund të kërkojë marrësit të ndihmës të rimbursojë të gjitha ose ndonjë pjesë të shumës së disbursimeve sipas kësaj marrëveshjeje për ose në lidhje me mallrat ose shërbimet e tilla në dollarë amerikanë ndaj USAID-it brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas marrjes së kërkesës për to.

c) E drejta sipas nënseksioneve (a) ose (b) për të kërkuar një rimbursim të një disbursimi do të vazhdojë, pavarësisht ndonjë dispozite tjetër të kësaj marrëveshjeje, për tre vjet nga data e disbursimit të fundit sipas kësaj marrëveshjeje.

d) 1. Çdo shlyerje sipas nënseksioneve (a) ose (b), ose (2) çdo shlyerje e bërë USAID-it nga një kontraktor, furnitor, bankë ose palë e tretë në lidhje me mallrat ose shërbimet e financuara sipas marrëveshjes, shlyerje, e cila lidhet me një çmim të paarsyeshëm ose faturim të gabuar të mallrave ose shërbimeve, ose për mallrat që nuk përputhen me specifikimet ose shërbimet që kanë qenë të papërshtatshme: A) ofrohet fillimisht për marrëveshjen, në masën e justifikuar; dhe B) pjesa e mbetur, sipas rastit, përdoret për të ulur shumën e ndihmës.

e) Çdo interes apo e ardhur tjetër nga fondet e disbursuara nga USAID-i për Përfituesin e Ndhmës sipas kësaj marrëveshjeje, para përdorimit të autorizuar të këtyre fondeve për marrëveshjen do t'i kthehen USAID-it në dollarë amerikanë nga ana e Përfituesit të Ndhmës, nëse USAID-i nuk bie dakord ndryshe me shkrim.

Seksioni E.3 Mosheqja dorë nga mjetet ligjore. Asnjë vonesë në ushtrimin e një të drejte ose mjeti ligjor që i takon një pale në lidhje me financimin sipas kësaj marrëveshjeje, nuk interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë ose mjet ligjor.

Seksioni E.4 Transferimi. Përfituesi i Ndhmës, me kërkesë, bie dakord të ekzekutojë një transferim tek USAID-i të çdo shkaku padie që mund t'i lindë Përfituesit të Ndhmës në lidhje me ose që rrjedh nga përmbushja kontraktuale ose shkelja e përmbushjes nga një palë të një kontrate të drejtpërdrejtë me dollarë amerikanë që USAID-i ka financuar plotësisht ose pjesërisht nga fondet e dhëna nga USAID-i sipas kësaj marrëveshjeje.

Neni F  
**Të ndryshme**

#### Seksioni F.1. Promovimi i investimeve

a) Përveç kur është parashikuar specifikisht nga kjo marrëveshje ndihme ose kur është autorizuar ndryshe nga USAID-i me shkrim, asnjë fond ose mbështetje tjetër e dhënë nuk mund të përdoret si nxitje financiare për një ndërmarrje biznesi që ndodhet aktualisht në Shtetet e Bashkuara me qëllim që të inkurajojë një ndërmarrje të tillë, që të zhvendoset jashtë Shteteve të Bashkuara në rast se një nxitje e tillë

ka të ngjarë të zvogëlojë numrin e punonjësve të kësaj ndërmarrjeje në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për shkak se prodhimi është duke u zëvendësuar nga një ndërmarrje e tillë jashtë Shteteve të Bashkuara.

Seksioni F.2. Planifikimi familjar vullnetar. Asnjë nga fondet e USAID-it të dhëna sipas kësaj marrëveshjeje apo mallrat ose shërbimet e financuara nga këto fonde, nuk mund të përdoret për:

a) Kryerjen e sterilizimeve jovullnetare si një metodë e planifikimit familjar ose për të detyruar apo ofruar stimul financiar një personi për t'iu nënshtruar sterilizimit;

b) 1. i) Prokurimin ose shpërndarjen e pajisjeve të destinuara për t'u përdorur për qëllimin e shkaktimit të abortit si një metodë e planifikimit familjar; ii) tarifa speciale apo stimuj për çdo person të cilat motivojnë ata për të pasur aborte; iii) pagesa ndaj personave që kryejnë aborte, ose kërkim personash që t'i nënshtrohen abortit; iv) informacion, edukim, trajnim ose programe komunikimi që kërkojnë të promovojnë abortin si një metodë të planifikimit familjar; dhe v) lobimin për apo kundër abortit. Termi "motivim", në lidhje me ndihmën e planifikimit familjar, nuk duhet të interpretohet për të ndaluar dispozitën, në përputhje me ligjin vendor, të informacionit ose këshillimit në lidhje me të gjitha opsionet e shtatzënisë ose

2. Një kërkim biomjekësor që lidhet, plotësisht ose pjesërisht, me metodat ose kryerjen e aborteve ose sterilizimeve të pavullnetshme, si një metodë planifikimi familjar. Kërkimet epidemiologjike apo përkruese, që vlerësojnë shpeshësinë, masën apo pasojat e aborteve, nuk përjashtohen.

c) USAID-i lëshon dokumente zbatimi që përshkruajnë në mënyrë më të plotë kërkesat e këtij seksioni.

Seksioni F.3. Të drejtat e punëtorëve. Përveç kur është parashikuar specifikisht nga kjo marrëveshje ose kur është autorizuar ndryshe nga USAID-i me shkrim, asnjë fond ose mbështetje tjetër e dhënë nuk mund të përdoret për ndonjë aktivitet që kontribuon në shkeljen e të drejtave të punëtorëve të njohura ndërkombëtarisht në vendin partner.

Seksioni F.4. Financimi i terrorizmit. Në përputhje me rezolutat e shumta të Kombeve të Bashkuara të Këshillit të Sigurimit, si USAID-i dhe partneri janë të angazhuar në mënyrë të vendosur në luftën ndërkombëtare kundër terrorizmit, dhe në veçanti kundër financimit të terrorizmit. Politika e USAID-it është që të kërkojë të sigurohet se asnjë nga fondet e saj nuk është përdorur, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për të siguruar mbështetje për individët ose subjektet e lidhura me terrorizmin. Në përputhje me këtë politikë, partneri pajtohet me përpjekje të arsyeshme për të siguruar që asnjë nga fondet e USAID-it, të parashikuara sipas kësaj marrëveshjeje, të përdoren për të siguruar mbështetje për individët ose subjektet e lidhura me terrorizmin. USAID-i mund të lëshojë dokumente zbatimi që përshkruajnë në mënyrë më të plotë kërkesat e këtij seksioni.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 40 lekë